



© LOGOS - A
2 0 0 3



S H K U P
P R I S H T I N Ē
T I R A N Ē



▲ Munir Gavrankapetanović

▲ Në rrugën e
▲ ngushëllimit
▲ e të shpresës





▲ Përktheu nga boshnjakishtja:

▲ **Muhidin Ahmeti**

▲ Titulli i originalit:
▲ Na putu utjehe i nade
▲ Sarajevo, 1990

▲ **Munir Gavrankapetanoviq**

▲ **Në rrugën e
▲ ngushëllimit
▲ e të shpresës**



Përmbajtja:

Parathënie	6
Dhembjet, vuajtjet dhe vdekja janë realitet	8
Në horizontin e shpresave tona është Zoti krijues	12
Lajmi i gëzueshëm	16
Krijuesi ka paralajmëruar sprovën	19
Besimtari duhet të jetë i guximshëm, i durueshëm dhe i gëzuar	25
Dhembja është me vlerë dhe vuajtja ka kuptim	30
All-llahu na thërret në lutje	42
Duhet t'i lutemi All-llahut xh. sh.	45
Lutje për qetësim dhe ngushëllim	51
Emrat më të bukur dhe atributet e All-llahut xh. sh. janë:	53
Lutjet e të dërguarit të Zotit – Muhammedit a. s.	55
Bamirësia	60
Duhet të mjekohemi	62
Besimtari shembullor në dhembje	73
Kalimi në botën e amshuar	83
Prehja në vdekje	92

PËRKUSHTIM:
*Shpirtit të Babës Hoxhë
(Mulla Xhavid Ahmetit)
për punën dhe misionin e tij të shenjtë,
për rrugën dhe mësimet e para që m'i dha.*

Përkthyesi

Parathënie

Rrugët e jetës së njeriut nuk janë të thjeshta e të lehta. Ato kalojnë shpesh nëpër dhembje, vuajtje, prova e pengesa. Gëzimet dhe buzëqeshjet, brengat dhe lotët janë shoqëruesit e vazhdueshëm në rrugën e jetës së njeriut. Gjatë gjithë jetës njerëzore, si ndër stinë ndërrohen ditët e nxehta, të kthejllëta dhe me diell me ditët e dimrave të ashpër, stuhive e reve të errëta.

Në faqet e këtij libri autori bën përpjekje të tregojë rëndësinë e madhe morale e shpirtërore të Porosisë së All-llahut xh.sh. Fuqia e besimit i ofron njeriut shpresën, ngushëllimin dhe ndihmën për kapërcimin e telasheve e të dhembjeve. Besimtari e pret me qetësi ballafaqimin e drejtpërdrejtë me frymën misterioze të vdekjes.

Libri “Në rrugën e ngushëllimit e të shpresës” bën një analizë të thellë të gjendjes shpirtërore, nganjëherë me tone edhe mistike, por çdo gjë është në funksion të përpjekjeve të njeriut për të ngadhënjyer mbi dhembjen, sëmundjen e vuajtjen.

Tematika që trajtohet në këtë libër është shumë e nevojshme në ditët e sotme të shekullarizimit të theksuar, për të plotësuar atë boshllëk të edukimit moral dhe shpirtëror të krijuar me dekada të tëra tek populli shqiptar. Në libër vend kryesor zënë besimi, shpresa, ngushëllimi dhe qetësia, e këto që të gjitha janë të domosdoshme për çdo njeri dhe nuk ka pengesa që do të kufizonin dëshirën e vazhdueshme të njerëzve për to.

Libri “Në rrugën e ngushëllimit e të shpresës”, në të vërtetë është ushqim shpirtëror që nëpërmjet besimit në Zotin i jep njeriut një ndjenjë të tillë sigurie që s’mund të zëvendësohet e të plotësohet me asgjë tjetër.

Falënderojmë All-llahun xh.sh. që na bëri të mundur të përfundojmë përkthimin e librit “Në rrugën e ngushëllimit e të shpresës” të autorit boshnjak Munir Gavrankapetanoviq (Ismet U. Shehibrahimoviq). Për vlerat e tij lexuesi do të thotë fjalën e vet.

Përkthyesi

Dhembjet, vuajtjet dhe vdekja janë realitet

Rruga e jetës së njeriut, që nga lindja deri në vdekje, është plot pengesa. Sëmundjet, vuajtjet e fatkeqësitë janë bashkudhëtarë të njeriut. Ato janë dukuri të realitetit jetësor me të cilin ballafaqohemi çdo ditë. Edhe ne jemi pjesëmarrës në ngjarjet e papritura të jetës.

Takojmë njerëz, që vuajnë nga sëmundjet, të dërrmuar nga dhembjet.

Takojmë të paralizuar, të cilët jetojnë të paaftë me muaj e me vite.

Takojmë invalidë në karroca e me paterica, që ecin me vështirësi.

Takojmë njerëz të shurdhër, memecë, të verbër.

Takojmë njerëz, të cilët nga dhembjet e tmerrshme të tumorit, përjetojnë një luftë të vështirë me vetveten.

Takojmë njerëz të paaftë e të lodhur shpirtërisht, që kanë rënë në depresione të rënda nervore.

Takojmë ata mbi të cilët janë shtrirë krahët e zinj të vdekjes. Ballafaqimi me sëmundje e vuajtje mund të radhitet deri në pakufi. Vështirësitë që e rrethojnë njeriun janë të panumërta. Ne marrim pjesë plotësisht në të gjitha ndryshimet dhe stuhitë që ndodhin në jetën tonë e përreth nesh. Asgjë dhe askush nuk mund të na shmanjë nga vështirësitë dhe fatkeqësië. Ato në tërësi janë reale e jetësore.

Të gjithë ata që vuajnë me trup e me shpirt, shpesh ballafaqohen me shfaqjet e tmerrshme të dëshpërimit,

mungesës së ndihmës, paaftësisë e të humbjes së shpresës. Të gjithë atyre që vuajnë çaste të vështira, herë-herë u duket sikur janë të mbështetur me shpatulla pas murit dhe ata nuk kanë asnjë mundësi për të dalë nga kriza dhe për të shpëtuar.

Dhembja të përpëlit. Të sëmurëve shpesh u duket se janë të vetmuar, se nuk ua kuptojmë sa duhet vuajtjet dhe se nuk ka përkushtim e mirëkuptim të mjaftueshëm për ta. Në të vërtetë, jeta, përveç gëzimeve, ka edhe halllet e veta të shumta dhe nëpërmjet këtyre njëkohësisht ajo ecën e kalon.

Ndërsa në horizontin e afërt apo të largët, drejt të cilit njeriu ecën i sigurt, plotësisht i sigurt, gjithnjë shfaqet ndarja me këtë botë, vdekja.

Ajo qarkullon kudo rreth nesh. Çdo gjë materiale shuhet dhe kalon duke u tretur në pafundësi. Zhduken yje, planete dhe botë të tëra. Varret të panumërta mbulojnë tokën. Edhe në trupin tonë çdo ditë vdesin mijëra qeliza dhe riprodhohen të tjera, të cilat edhe ato së shpejti mund të vdesin. Vdekja herë-herë është krejt afër, nganjëherë duket se është larg. Mirëpo, ajo është gjithnjë pranë, sillet rreth njeriut dhe ndihet fryma e saj. Vdekja na shoqëron që nga lindja dhe, sikur është pjesë përbërëse e qënies sonë dhe e jetës sonë.

Ajo është një nga sekretet e çuditshme të jetës. Vdekja është fjalë që vetvetiu të frikëson, por edhe zgjon kureshtje dhe ngjall interesim. Takimi me të shpesh shkakton panik. Shumë njerëz nuk dëshirojnë as të flasin për të, nuk dëshirojnë as të mendojnë për të. Çdo bisedë rreth saj, madje vetë ideja e vdekjes, sjell mendime ogurzeza mbi kobin që mund të na gjejë.

Çdo njeri e di se do të vdesë patjetër dhe askush e asgjë në këtë botë nuk mund ta ndalë dhe ta pengojë atë ecje të sigurt drejt përfundimit tonë.

E dimë se patjetër duhet të vdesim, por, megjithatë, e largojmë nga vetja çdo ide mbi të vdekurit. Jemi të gatshëm të bisedojmë për çdo gjë tjetër, vetëm për vdekjen jo. Të gjithë jemi të bindur, edhe ata të cilët do të vdesin sot apo nesër se vdekja është akoma larg. Megjithatë, kur ajo ndodh në afërsinë tonë, e përjetojmë thellë dhe fuqishëm.

Të gjithë ata që ballafaqohen me trupat e vdekur, e përjetojnë kryesisht me tronditje vdekjen duke e shikuar drejtpërdrejt para vetes. Shumë prej tyre në këtë rast i kap tmerri.

Në shmangien e bisedës nga vdekja, madje edhe nga ideja e saj, ndikon edhe fakti që vdekja është jashtë mundësisë së të kuptuarit tonë, sepse ajo është një mister i mbuluar me vellon sekrete të të moskuptuarit.

Kur flasim për të, shpesh i shmangemi së vërtetës së kulluar dhe e paraqesim me alegori ose përpiqemi ta zbusim përshtypjen që na lë ajo.

Disa madje e paraqesin si një vajzë të bukur me mantel të bardhë, ndërkaq një pjesë tjetër e njerëzve e përfytyrojnë, mbase që ta bëjnë sa më të huaj dhe sa më të largët nga të gjitha emocionet tona dhe afërsia jonë, si skelet njeriu i veshur me kostum të zi dhe me kosë në dorë, e gatshme të presë çdo jetë njerëzore.

E gjithë kjo është mekanizmi ynë mbrojtës njerëzor, i cili dëshiron që ne të jetojmë përjetësisht. Kjo dëshirë është e rrënjosur thellë tek ne në mënyrë instinktive. Dëshira për të jetuar përjetësisht është pjesa e qenies sonë. Forma e saj shfaqet në mënyra të ndryshme. Në varrin e njeriut neandertal, të vjetër rreth 100.000 vjet, me rastin e gërmimeve arkeologjike dhe sipas materialeve të gjetura në të është konfirmuar besimi në jetën që vjen pas vdekjes.

Atë besim e ndeshim tek sumerët, asirianët, kinezët, egjiptianët e vjetër. Zhvillimi i atij besimi vazhdon pandërprerje.

Vështirë është të jetosh me idenë gjithnjë të pranishme për përfundimin e pashmangshëm. Vështirë është për njeriun të besojë në vdekjen personale, e cila do ta mbulojë me vellon e harresës gjithçka që ka përjetuar, që ka ndier. Është e dhembshme ta pranojmë vdekjen e përjetshme të të afërmeve tanë dhe të pajtohemi që nënën tonë, babanë, vëllanë apo motrën nuk do t'i shohim më asnjëherë, me të vërtetë asnjëherë.

Vallë, si është e mundur që çdo gjë shpirtërore që e kemi mbartur në vete, tërë dashuria, mirësia, fisnikëria dhe virtytet e tjera të shkëlqyera të zhduken përgjithmonë?

Të gjitha këto pyetje, të gjitha këto dilema e trondisin shumë njeriun. Ai nuk dëshiron të largohet nga mendimet për jetën e përjetshme apo për vdekjen e përjetshme. Ato, sikur e shtyjnë në studime apo meditime këmbëngulëse shpirtërore.

Në horizontin e shpresave tona është Zoti krijues

Dhe njeriu pyet: kush jam, ku do të shkoj? Që kur, deri kur është jeta, ekzistenca, gjithësia?

Ç'është jeta, përse na pllakosin sëmundjet, ç'është vdekja?

Mendimi njerëzor kur fillon të futet në hapësirat e pakufishme kohore si në retrospektivë, ashtu edhe në perspektivë, kur ai mendim përpiqet të depërtojë në hapësirën e pakufishme duke vëzhguar në të gjitha drejtimet nga toka, ai e kupton që nuk ka fund dhe patjetër do të ndeshë në një perde, pas së cilës fshihet sekreti i jetës. Ajo perde është e pakapërcyeshme për mendjen tonë dhe për të kuptuarit tonë të tanishëm. Ku është pra, përgjigjja për të gjitha pyetjet dhe të gjitha sekretet që na rrethojnë?

Nganjëherë përpiqemi t'i gjejmë përgjigjet, herë-herë qëndrojmë të nemitur e të mahnitur para murit të heshtjes. Kur arrijnë sprovat, kur lëshohen mbi ne vuajtjet e sëmundjet, kur fillojmë më me intensitet të jetojmë në mënyrë shpirtërore, të gjitha ato pyetje, sipas përmasave të tyre, fitojnë rëndësi tejet të madhe. Thjesht, sikur të shtynjë në zgjidhjen e sekreteve. Ato janë çaste të mrekullueshme të përpjekjeve të njeriut, që të zbulohen veçllot e së panjohurës. Njeriu atëherë me mendimin dhe këmbënguljen e tij të madhe kërkon njohuri aq shumë të

dëshiruara. Ai është i vendosur të kuptojë domethënien dhe fshehtësinë e jetës. Përpiqet të futet në fshehtësinë e natyrës, në qenësinë e saj të mrekullueshme, sepse njeriu është pjesë e natyrës, pjesëmarrës në të dhe në çdo gjë që ndodh. Misteri i jetës ndodhet çdokund.

Nëse drejtojmë shikimin tonë në një lule që ndodhet para nesh, mendja jonë ndalet e mahnitur para ndërtimit të saj të përsosur, para ngjyrave, bukurive e aromave të saj të mrekullueshme. Gjithashtu një mrekulli e veçantë është të kuptuarit e pjalmimit të lules – të kësaj vepre madhështore. Dhe sa më shumë e më thellë t'i kuptojmë gjërat, gjithnjë e më tepër do të na shfaqet krijimi me aq urtësi i bimëve, krijimi në të cilin nuk ka gabime.

Nëse shikojmë organizimin tonë, mahnitja, harmonia dhe përkryeshmëria nuk kanë fund. Çfarë vepre madhështore është vetëm krijimi i syrit, veshit... të njeriut! Sa përsosshmërisht është krijuar zemra, mëlçitë! Truri, ky organ i mrekullueshëm i trupit njerëzor, me rreth 10 miliardë qeliza, është vepër e përkryer! Kompjuteri më modern është lojë në krahasim me të. Është llogaritur se numri i informacioneve që mund të pranojë e të japë një qelizë nervore – neuroni është aq i madh, sa do të duhe-shin përdorur një numër i paimagjinueshëm kalkulatorësh.

Duke u njohur me proceset e metabolizmit të organizmit njerëzor, ne magjepsemi nga përsosmëria e jash-tëzakonshme e tyre. Çdo gjë punon në harmoni, në mënyrë të përkryer e mrekullisht mirë e bukur. Këto njohuri na shtojnë të kuptojmë se çdo gjë është e krijuar me arsye dhe urtësi. Pa një Mendje të Lartë, të gjitha këto nuk do të ekzistonin!

Natën në qiellin e kthjellët duken yje të panumërta. Kur shikojmë me teleskop në gjithësi, sikur s'ka fund numri i trupave qiellorë. Në thellësinë e hapësirave të pakufishme kozmike lëvizin biliona diej. Disa prej tyre

janë aq të mëdhenj, saqë, sipas vëllimit, ia kalojnë Diellit tonë në qindra e mijëra herë, kurse Dielli ynë është 1.300.000 herë më i madh se Toka. Të gjitha këta trupa të panumërt kozmikë rrotullohen rreth boshteve të tyre, rreth qendrave të tyre duke lëvizur nëpër gjithësi me shpejtësi të paimagjinuar për mendjen tonë njerëzore. Dhe s'ka askund përplasje, askund çrregullim! Në atë orar udhëtimi nëpër gjithësi, nëpër rrugët e caktuara saktësisht, mbretëron harmoni e përkryer.

Prania e një Mendjeje të Jashtëzakonshme në krijimin e gjithësisë e të trupave qiellorë dhe të ligjeve që mbretërojnë në të është aq evidente saqë pa thënë asnjë fjalë, të mahnitur, të çuditur dhe të magjepsur qëndrojmë memecë para Madhësisë së Tij të Mrekullueshme.

Vetvetiu njeriut i lindin mjaft pyetje që kërkojnë përgjigje: Si u krijuan në të vërtetë të gjitha këto? Vallë, a është e mundur që tërë gjithësia kaq e përbërë dhe e mrekullueshme të krijohet rastësisht, pa praninë e Një Mendjeje të Jashtëzakonshme?

Vallë, a është e mundur të krijohen vetvetiu gjithë ata trupa kolosalë e të panumërt dhe të lëvizin vetvetiu? Edhe topi i thjeshtë ka punëtorin dhe makinën që e ka prodhuar dhe individin që e vë në lëvizje.

Njëkohësisht mendimi njerëzor, shko nga atomi deri te qeliza e gjallë, nga gjethi deri te blea, nga thnegla dhe krijesat e gjalla deri te ligjet e pandryshueshme dhe të përkryera natyrore, të cilat i hasim dhe i zbulojmë në çdo hap dhe sipas të cilave zhvillohet jeta në Tokë e në gjithësi...

Çdo gjë që na rrethon dëshmon plotësisht të vërtetën për urtësinë e krijimit, për veprën e një Mendjeje të Lartë. Veprën e asaj Mendjeje e ndiejmë edhe ne në veten tonë, në zemrën tonë, në unin tonë, të cilin e quajmë shpirt. Ndërgjegjja jonë, të gjitha veprat tona shpirtërore janë vepra të Tij.

Mendimet tona, ndjenjat tona, natyra që na rrethon, shkenca e cila na zbulon të panjohurën, çdo gjë, vërtet çdo gjë na çon te njohja e sigurt për domosdoshmërinë e ekzistencës së një Mendjeje Absolute, Krijuesit të Amshuar, i cili çdo gjë të gjallë dhe jo të gjallë e krijoj në mënyrë të mrekullueshme e misterioze, i Cili e vuri në lëvizje tërë jetën dhe i Cili drejton dhe sundon me të gjitha ato. Zoti, Krijuesi ynë, manifestohet në çdo gjë që e shohim, e dëgjojmë dhe e ndiejmë. Me të vërtetë, s'ka dyshim: Krijuesi ekziston me siguri, jemi plotësisht të bindur për këtë. Ai është e Vërteta Absolute për të Cilin nuk ka fare dyshim.

Lajmi i gëzueshëm

Po, njohuritë dhe ndjenjat tona flasin për ekzistencën e sigurt të Krijuesit. Por Krijuesi ynë, edhe Ai nuk deshi të mbetet i fshehur dhe për këtë arsye gjatë historisë njerëzore, përmes njerëzve të zgjedhur, të ndershëm, me cilësi të shkëlqyeshme shpirtërore e morale, të pajisur me njohuri të jashtëzakonshme, të pakapshme për njeriun e zakonshëm, dërgoi më shumë se njëherë Shpalljen mbi ekzistencën e vet, u dërgoi Porosinë dhe mesazhin e Vet njerëzve si lajmin më të gëzueshëm.

Krijuesi ynë – All-llahu xh.sh. në Kur'an na e shpalli të vërtetën mbi ekzistencën e Tij përmes të dërguarit të fundit, Muhammedit a.s.

“Vallë, a ka dyshim në All-llahun – Krijuesin e qiejve e të Tokës?” (Ibrahim (14):10)

“Ha. Mim. Kjo është Shpallja nga i Gjithmëshirshmi, Mëshirëploti. Ky është Libri, ajetet e të cilit janë mirë të shkoqitur. Ky është Kur’ani në gjuhën arabe për njerëzit që dinë. Sjell lajme të gëzueshme dhe paralajmëron për pasojat e rrugës së padrejtë:” (Fussilet (41):1-4)

“Librin e shpalli All-llahu, i Forti, i Urti!

Në qiej dhe në Tokë, me të vërtetë ka argumente për besimtarët. Edhe në krijimin tuaj dhe të shtazëve që i ka shpërndarë ka argumente për njerëzit që janë të bindur.

Edhe në ndërrimin e natës e të ditës dhe në shiun që All-llahu e lëshon nga qielli, që me anën e tij e ngjall tokën, pasi të

ketë vdekur, si dhe ndërtimi i erërave – janë argumente për njerëzjtë e mençur.

Këto janë argumentet e All-llahut, që t'i kumtojme me saktësi.

Po cilat fjalë ata besojnë në mos fjalët e All-llahut dhe argumentet e Tij?” (El-Xhathije (45):2-6)

“Argumentet në Tokë janë për ata që e besojnë me bindje. Argumente ka edhe në veten tuaj. A nuk i shihni? (Edh-Dharijat (51):20-21)

“Ai është, i Cili u dërgoi analfabetëve një Pejgamber nga mesi i tyre, t’ua lexojë ajetet e Tij, t’i pastrojë dhe t’ua mësojë Librin dhe Urtësinë, sepse më herët kanë qenë në humbje të hapët. U dërgoi edhe të tjerëve që nuk i arritën ata – Ai është i Forti dhe i Urti.

Ajo është mirësi e All-llahut, që ia jep kujt të dojë, All-llahu është burim i mirësisë së madhe.” (El-Xhumua (62):2,3,4)

Në Kur’an dhe nëpërmjet fjalëve të Muhammedit a.s., All-llahu xh.sh. e shpalli lajmin e gëzuar për të gjithë njerëzjtë e botës. E hoqi vellon nga sekreti i jetës aq interesante për çdo njeri.

Dha përgjigje për të gjitha pyetjet që me mijëra vjet e mendojnë njeriun, dha përgjigje madje edhe për pyetjen e sekretit të jetës. E tregoi rrugën e ndritshme e të drejtë kah lumturia dhe paqja në këtë botë dhe në përjetësi. Të sëmurëve dhe atyre që vuajnë u ofroi dhe në përjetësi. Të sëmurëve dhe atyre që vuajnë u ofroi ngushëllim dhe shpresë, ngushëllimin aq të kërkuar dhe aq të nevojshëm. Paralajmëroi të kuptuarit e vërtetë mbi sekretin e vuajtjeve njerëzore dhe lotin e fshirë, buzëqeshjen në vend të fytyrës së brengosur, shpresën në vend të pashpresës, qetësinë në vend të dëshpërimit, në vend të mendimeve mbi vdekjen e përjetshme paralajmëroi shpresën në jetën e përjetshme, në lumturinë e bukur, të pashprehur me fjalë.

Shpresa është një mëshirë e madhe e All-llahut për pasardhësit e mi. Po të mos ishte shpresa, nëna nuk do t'i jepte gjë fëmijës, as pemëtari nuk do ta mbëltonte fidanin. (Hadith)

Me urti është thënë: “Shpresa është nëna e të gjithë njerëzve!”

Shpresë të madhe i dha All-llahu xh.sh. njeriut:

“Ju keni shembull të mrekullueshëm në Pejgamberin e All-llahut, për atë që shpreson në mëshirën e All-llahut dhe shpërblimin në botën tjetër”. (El-Ahzab (33): 21)

Krijuesi ka paralajmëruar sprovën

Zoti me mirësinë e vet gjen mënyra të pakufishme, të mira dhe fisnike për të hapur dyert e paqes, ngushëllimit, lumturisë dhe shpëtimit për çdo njeri. Ato mënyra janë herë të padukshme fare, herë-herë të panjohura, të mbuluara me vello sekrete, nganjëherë për njeriun e thjeshtë, të çuditshme dhe të pakuptuara.

Ne vetëm duhet të besojmë fuqishëm, të jetojmë me nder dhe të jemi fort të bindur se çdo gjë që All-llahu xh.sh. na mëson, për çdo gjë që na udhëzon dhe çdo gjë që na dërgon është e mirë për ne. Sekretet e sprovës në vuajtje, që feja na paralajmëron, është njëra prej mënyrave që na çon drejt lumturisë së vërtetë dhe shpëtimit.

“Ne do t’ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me humbjen e pasurisë, shpërtrave dhe të lashtave. Dhe ti përgëzoji besimtarët. Ata të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: Ne jemi të All-llahut dhe tek Ai do të kthehemi, ata do të shpërblehen me beki-me dhe mëshirë nga Zoti i tyre, ata janë në rrugën e drejtë”. (El-Bekare (2): 155-157)

Sprova mund të vijë, por zemra e besimtarit të vërtetë asnjëherë nuk do të dëshpërohet. Ajo do ta madhërojë All-llahun e Dashur edhe në çastin e agonisë së fundit. Ajo është zemra e cila është betuar:

“Dëgjoj dhe nënshtrohem!”

Zoti u Urtë e di më mirë se të gjithë ne, kur dhe me ç’rast do t’ia çojë sprovën njeriut. Ajo do ta madhërojë All-llahun e Dashur dhe në çastin e agonisë së fundit.

Ne njerëzit nuk e dimë sa do ta zgjasë ajo, cila do të jetë forma dhe mënyra e saj. Këtë e di vetëm All-llahu xh.sh.

Në të vërtetë ajo është e rëndë, plot me pyetje dhe pengesa, mirëpo besimtari atë e kupton shumë qartë: Sprovën e çon All-llahu xh.sh. dhe Ai është Miku dhe Ndihmësi më i madh i besimtarit. All-llahu është e Mira e pasosur. Ai është vetë Dashuria. Ai kujdeset për ne. Në këtë besimtari duhet të jetë i bindur. Ne njerëzit jemi kufizuar në dije dhe asnjëherë nuk mund të depërtojmë në esencën dhe sekretin e përcaktimeve të All-llahut xh.sh. Duhet ta kemi gjithmonë në kujtesë që një nga emrat e Zotit është edhe Ai që dashuron. Ne kemi besim tek të afërmit dhe tek miqtë tanë, por besimin më të madh duhet ta kemi tek All-llahu (Qoftë lartësuar Emri i Tij), tek Vullneti i Tij dhe tek përcaktimi i Tij. Me këtë besim asnjëherë nuk do të jemi të mashtruar as të braktisur, asnjëherë nuk do të dëshpërohemi, madje edhe atëherë kur Zoti, me providencën e Tij na çon dhembjen më të rëndë.

Besimtari e ndien dhembjen e trupit e të shpirtit, ai e ndien barrën e sprovës, por ai njëherësh e di që në çdo vendim të Zotit ka një kuptim më të lartë, që ne, njerëzit nga pozicionet tona njerëzore, nuk mund ta kuptojmë plotësisht.

Për besimtarin çdo gjë që vjen nga All-llahu xh.sh. është dhurata më e mirë, madje edhe vdekjen kur të vijë, besimtari do ta pranojë si të tillë. Intensiteti i sprovës drejtuar zemrës së besimtarit rritet me forcën e imanit të tij dhe me pozicionin e tij që ka në botën shpirtërore të fesë. Sa më i fuqishëm imani (besimi), sa më i lartë niveli shpirtëror, aq më e madhe është prova.

Gjatë historisë së gjinisë njerëzore prova ka qenë dhe do të jetë shoqëruesi i përjetshëm i njeriut. Gjithnjë janë sprovuar më të afërmit dhe më të dashurit e Zotit xh.sh.

All-llahu xh.sh. e ka vënë në sprovë Ejubin, Ibrahim, Idrizin, Nuhin, Hudin, Lutin, Jakubin, Jusufin, Suljmanin (Paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi ta), i ka sprovuar të njohurit dhe të panjohurit, peygamberët dhe njerëzit e mirë.

Një herë e pyetëm Muhammedin a.s. se cilët njerëz do të bien më shumë në sprovë.

Ai u përgjigj: “Peygamberët, ata që janë shembullorë dhe pastaj më të mirë”.

“Njerëzit do të sprovohen sipas shkallës së besimit, kur njeriu e ka besimin e fortë, ai do të jetë i sprovuar më shumë, ndërsa kush e ka besimin e dobët, do të jetë i sprovuar më pak. Njeriu do të ketë telashe gjithmonë, madje edhe atëherë kur do të ecë në tokë plotësisht pa gjynahe”. (Hadithin e transmeton Ibni Habbani).

“Kur All-llahu e do robin e Vet, Ai i çon ndonjë sprovë për t’ia provuar bindjen dhe lutjen e tij” (Hadith).

“Nëse All-llahu të provon me ndonjë të keqe, atë s’mund ta largojë askush përveç Tij, por, nëse dëshiron të të japë ndonjë të mirë, askush nuk mund ta pengojë dbuntinë e Tij. Ai me të shpërblen atë që do nga robërit e Tij. Ai fal dhe mëshiron shumë. (Junus (10): 107)

All-llahu xh.sh. ka mundur t’u japë besimtarëve lumturi e begati të përjetshme edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër, pa i sprovuar fare bile vetëm për besimin e shprehur me fjalë, pa kurrfarë mundimi dhe përpjekjeje të besimtarit. Po, ka mundur Ai ta bëjë këtë. Mirëpo Zoti i Urtë ka dashur që besimi i shprehur me fjalë dhe i shoqëruar me përpjekje, mund e vuajtje të jetë i dëshmuar me të dëgjuarit dhe me të nënshtruarit ndaj vullnetit të All-llahut xh.sh. Për këtë ai ka arsye të mëdha. Sepse...

Zoti i Dashur e di se besimi i shprehur me fjalë dhe vepra është parim themelor, bazë për çdo lumturi e mirëqenie të vërtetë të besimtarit.

Ai e di që rrugëdalja e vetme nga çdo vështirësi është besimi, besimi pa dyshime, pa pyetje, pa kërkesa, sado që dhembja dhe vuajtja të jenë të vazhdueshme dhe të rënda për nga intensiteti i tyre. Ai e di se çdo hap në rrugën jetësore të njeriut besimtar, vetëm me besim të dëshmuar fort mund të ketë rezultate të vërteta. Vetëm në këtë mënyrë hapen gjerë e gjatë rrugët e mirëqenies, lumturisë dhe shpëtimit në të dyja botët.

Zoti xh.sh. e di se njeriu duke zbatuar Fjalën e Tij dhe duke ecur guximshëm me besim bëhet njeri. Ai do atë që i ka virtytet më të bukura. Pikërisht në rrugën e Zotit xh.sh., sipas vullnetit të Tij, njeriu i frymëzuar me besim universal e flak gjithë të keqen e vet dhe përreth vetes, të gjitha shprehitë dhe veprimet e këqija duke u bërë plotësisht njeri i vërtetë.

Zoti xh.sh. e di që, kur të vijnë sprovat, kur të vjen dhembja, kur ta kap njeriun sëmundja, madje edhe vdekja, për besimtarin nuk ka zgjidhje dhe shpëtim tjetër përveç besimit.

Prandaj All-llahu xh.sh., duke i dëshiruar besimtarit vetëm të mirën, kërkon që hapi i parë i tij në çdo rrugë, por edhe në rrugën e sprovës, të jetë besimi i pastër dhe i pakompromis, besimi i cili gjithmonë dhe pa kurrfarë luhatjesh konfirmon: Nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut – Vetëm Ai është Zot! All-llahu xh.sh. kërkon nga mu'mini (besimtari) besim pa kundërshtim, besim me të cilin do t'i japë Atij, Krijuesit të vet, zemrën e vet, mendimet e veta, shpirtin e vet, çdo gjë prej vetes. Ky besim i sjell fitore Fjalës së All-llahut xh.sh. në tërë qenien e besimtarit.

Është me rëndësi për besimtarin të kuptojë se gjatë sprovimit të dhembshëm All-llahu xh.sh. përcjell me vëmendje e me kujdes të plotë çdo ndodhi në zemrën e tij. All-llahu xh.sh. e di me Providencën e Tij tërë madhësh-

tinë dhe dobinë e sprovës, prandaj ia dërgoi atij. Ai dëshiron që besimtari nëpërmjet sprovës të dalë shpirtërisht më i pasur dhe më i mirë, veti këto që fitohen vetëm përmes rrugës së sprovës. Mirëpo duke sprovuar All-llahu xh.sh. besimtarin, Ai me Mëshirën dhe Mirësinë e Tij të pakufishme i tregoi edhe rrugët, të cilat do ta ndihmojnë që t'i tejkalojë sa më lehtë ato dhe përveç kësaj do ta shpërblejë me vlera të mrekullueshme, të cilat e ngrenë njeriun në shkallët më të larta shpirtërore.

Besimi ndaj Zotit xh.sh. është udhërrëfyesi më i madh e më i mirë që tregon kapërcimin e sprovës. Besimi i fuqishëm i hap gjerë e gjatë dyert për kalim të mbarë e të bekuar nëpër sprovë.

Në fuqinë e fesë, nëpërmjet sabrit (durimit), tevekulit (mbështetjes tek Zoti) dhe teslimijetit (devocionit) ndaj All-llahut xh.sh., vazhdon ndriçimi i mëtejshëm i rrugës së mirë. Nëpërmjet pranimit të guximshëm të vuajtjes dhe të devocionit, besimtari bëhet gjithnjë e më i vetëdijshëm se po i nënshtrohet vullnetit të All-llahut xh.sh. dhe me këtë po e arrin kënaqësinë e Tij. Këto janë cilësi të shkëlqyera, që e bëjnë njeriun njeri të vërtetë dhe i sjellin shenja gëzimi për çdo të mirë në këtë botë dhe në botën tjetër dhe njëkohësisht e ndihmojnë që ta kalojë më lehtë sprovën.

Përveç kësaj, All-llahu xh.sh. thërret në dua, lutje, e cila trimëron dhe fisnikëron zemrat e njerëzve duke i afëruar ato nga Mëshira e vet, duke iu dhuruar shpresë.

Për të shpëtuar nga sprova, All-llahu xh.s. i ka udhëzuar besimtarët që të bëjnë gjithnjë dhe gjithkund vepra të mira, në mënyrë që të përhapin paqen e dashurinë ndër njerëzit, të largojnë çdo të keqe nga vetja dhe ta edukojnë personalitetin e tyre.

Me të gjitha këto udhëzime All-llahu xh.sh. i nxit përpjekjet e njerëzve të mirë, që të trimëruar e të fisnikë-

ruar të dalin nga zjarri i vështirësive më të mirë, më seriozë, më të ndjeshëm, përplot me vlera, të cilat ua hapin gjerë e gjatë portat e Xhennetit.

Me gjithë këto udhëzime e përpjekje, All-llahu xh.sh. i thërret të sëmuret që t'i kërkojnë të gjitha ilaçet e mira ekzistuese fizike e shpirtërore, në mënyrë që të shërohen dhe me njohuri të reja shpirtërore ta vazhdojnë jetën e tyre të ndershme e fisnike.

Por, edhe në qoftë se vjen vdekja, e ajo patjetër një ditë do t'i vijë çdokujt, me besim, sabër, mbështetje e dorëzim ndaj Zotit xh.sh., me bamirësi e lutje, ajo do të përballohet dhe do të pranohet më lehtë. Atëherë edhe agonia e vdekjes do të jetë e qetë, për shkak të takimit të pritur të shpirtit me Atë që e ka krijuar, si dhe për shkak të takimit me të gjithë njerëzit tanë të dashur dhe të afërm dhe me të gjithë njerëzit e mirë, të cilët tashmë janë shpërngulur në botën tjetër më të mirë.

Besimtari duhet të jetë i guximshëm, i durueshëm dhe i gëzuar

All-llahu xh.sh. ka thënë:

“O besimtarë, kërkoni ndihmë për vete duke duruar dhe duke kryer faljen! All-llahu, pa dëshim është me durimtarët”. (El-Bekare (2): 153)

“Ata që janë të durueshëm në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Ata janë se kanë qenë të sinqertë dhe vetëm ata janë të devotsbëm”. (El-Bekare (2): 177)

“Vetëm ata që janë të durueshëm do të shpërblehen pa masë.” (Ez-Zumer (39): 10)

Në të gjitha koleksionet e njohura të haditheve ka një hadith që e transmeton Enes Ibën-Malik e në të cilin thuhet se Pejgamberi i Zotit, Muhammedi a.s. ngushëlloi një grua e cila qante fëmijën e vet të vdekur me fjalët:

“Kije frikë All-llahun xh.sh. dhe duro!”

“Sabri provohet në goditjen e parë”

Është transmetuar edhe një hadith tjetër i cili flet për një besimtar të mirë i cili, kur i kishte vdekur fëmija, i ishte dorëzuar plotësisht All-llahut xh.sh. dhe e kishte përballuar me durim dhembjen e rëndë duke thënë:

“Faleminderit Zotit!” *“Ne jemi të All-llahut dhe tek Ai do të kthehemi!”*

Këtij qëndrimi tepër njerëzor, All-llahu xh.sh. i përgjigjet me Gjithëmëshirën dhe gjithë kujdesin e Tij duke i urdhëruar Melekët (Ëngjëjt) që atë njeri të shkëlqye-

shëm, atë besimtar të ndershëm, i cili edhe në vuajtjet më të rënda nuk e harroi Krijuesin e Dashur, ta shpërblejë me ndërtimin e një shtëpie në Xhennet me emrin “shtëpia e falënderimit”.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Kujt i bie një fatkeqësi, qoftë në trup (sëmundja), ose në pasuri dhe bën durim, a fsheh atë dhe nuk i ankohehet askujt, ka merituar faljen e gjynaheve nga ana e Allahut xh.sh.”

Ka një forcë të pakufishme në sabrin (durimin) e frymëzuar me besim tek All-llahu xh.sh. Njeriu nga natyra është i dobët, mirëpo me besimin që ka ai kapërcen çdo dhembje të shkuar dhe të tashme. SABRI nuk është pranim pasiv i gjendjes ekzistuese, por është sfidë aktive dhe shpirtërore ndaj sprovës dhe forcës së dhembjes, duke bërë çdo gjë nga të mirat e mundshme zotëruese, me qëllim që t’i shmanget fatkeqësisë. Mirëpo, në qoftë se vuajtjet e dhembjet janë shoqëruese të paevitueshme dhe të përvetshme, atëherë duhet të pajtohemi me fatin dhe me gëzim ta pranojmë atë.

Përveç sabrit (durimit) me rëndësi të madhe është edhe Tevekuli – mbështetja në ndihmën e All-llahut xh.sh. në çdo moment, madje edhe në çastet më të vështira të jetës. Në ato momente ka vlera shumë të mëdha edhe devocioni dhe të nënshtruarit ndaj All-llahut xh.sh. – Teslimijeti. Për besimtarin e vërtetë dhe të sinqertë, në momentet më të vështira është i mjaftueshëm vetëm All-llahu xh.sh.

“Neve na mjafton që kemi All-llahun. Ai është mbrojtësi më i mirë!” (Ali Imran (3): 173)

“Kini frikë All-llahun dhe besimtarët le t’i mbështeten vetëm All-llahut!” (El maide (5): 11)

Vetëdija se çdo gjë bëhet sipas Vullnetit të All-llahut, është forca kryesore që e kalit qëndrueshmërinë

dhe trimërinë në zemrën njerëzore. Burimi i kësaj vetëdije është besimi në All-llahun xh.sh. Ai është besimi që nuk njih kufij, e lartëson shpirtin, e përtërin atë dhe nëpërmjet dhembjeve e përgatit për shkallën më të lartë.

“Asnjë fatkeqësi nuk ndodh pa lejen e All-llabut dhe kush i beson All-llabut, Ai do t’ia udhëzojë zemrën e tij. All-llahu e di mirë çdo send”. (Et-Tegabunë (64): 11)

“Thuaj: “Nuk do të na godasë asgjë, përveç asaj që na e ka caktuar All-llahu, Ai është Zoti ynë. Dhe besimtarët le të mbështeten vetëm tek All-llahu!” (Et-Teube (9): 51)

Prandaj, edhe atëherë kur, madje pashpresa e shtrëngon shpirtin tonë, i pushton mendimet tona dhe atëherë kur duket se askund nuk ka dritë, nuk duhet të biem shpirtërisht, aq më pak të thërrasim vdekjen. All-llahu nuk i do ata që e humbin guximin.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Asnjëri prej jush nuk duhet ta kërkojë vdekjen për shkak të fatkeqësisë dhe dëmit që i është bërë, por, në qoftëse dikush tashmë e ka kërkuar, le të thotë: “Zoti im, më lër të jetoj deri sa jeta ime është e mirë, ndërsa ma jep vdekjen, kur ajo do të jetë më e mirë. Bëje që jeta ime të jetë shtesë në çdo të mirë, kurse vdekja, paqe dhe shpëtim nga çdo e keqe!”

Mendimtari indian Rabindranat Tagora ka shkruar:

“Nuk do të lutem për mbrojtje nga rreziku, veç që ta pres atë pa frikë; nuk dua të bëj lutje për mbarimin e dhembjeve, veç për guxim me të cilin do t’i ngadhënej ato; nuk do të kërkoj aleatë në arenën e jetës, veç qëndresën time personale; nuk do të kërkoj ndihmë në halle dhe frikë, veç do të pres me durim sa të lirohem nga ato; mos më lë të bëhem qyqar, por më bëj ta ndiej përkrahjen e dorës Sate, kur të më pritët fuqia”. (Tagore, “Fruit – Gathering”)

D.m.th. asnjëherë dëshpërim! Përkundrazi, me sabër (durim), tevekul (mbështetje tek Zoti), teslimijet (devocion) dhe guxim besimtari gjithnjë duhet ta tregojë gëzimin e shpirtit të tij, atë fryt të mrekullueshëm të Mëshirës së All-llahut xh.sh. Ai është predikues satisfaksionesh në fe edhe kur është i sëmurë rëndë. Nëse është i zymtë apo mbase i depresionuar, zbehtësia është shkëlqimi i besimit në fytyrën e tij.

Besimtari (mu'mini) duhet të jetë njeriu më i lumtur dhe më i gëzuar, sepse ka All-llahun xh.sh. Mikun më të Madh, ai është i vetëdijshëm që Zoti i Mirë është gjithmonë pranë tij. Gëzimi islam është kënga më e bukur e shpirtit njerëzor, që me qenien e vet i thur lavdi Emrit të Zotit xh.sh. Buzëqeshja në fytyrën e besimtarit tregon se është i fuqishëm besimi në zemrën e tij, sa fuqishëm e adhuron All-llahun xh.sh. All-llahu xh.sh. kënaqet me gëzimin e besimtarëve, qofshin të sëmurë apo të shëndoshë.

Shumë njerëz do të habiten dhe do të pyesin se prej nga vjen gëzimi tek njeriu që është i sëmurë dhe që vuan rëndë. Ka vetëm një përgjigje për këtë: nga besimi në Zotin xh.sh., nga dashuria ndaj Zotit dhe nga devocioni i pakufishëm ndaj Tij.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Njihe All-llahun dhe afroju Atij, kur je në mirëqenie (dhe rahati), sepse Ai do të të përkujojë ty dhe do të të ofrojë ndihmë, kur ta kesh më vështirë. Dije se ajo që të ka kapërcyer nuk ka qenë e mundur të të ndodhë, ndërsa ajo që të ka ndodhur ka qenë e pamundur të kapërcehet.

Dije përsëri që ndihma dhe sukcesi janë në durim; që pas hidhërimit ka ngushëllim, si dhe pas çdo vështirësie pason lehtësimi dhe mirëqenia.”

“Mbështetja më e mirë në jetë është durimi, ndërsa të presësh ndihmë (në situata të vështira) nga All-llahu xh.sh. është ibadet.”

“Admiroj muslimanin (dhe qëndrimin e tij) kur e godet ndonjë fatkeqësi, ai e përballon me durim dhe shpreston në shpërblimin; ndërsa, kur i vjen ndonjë e mirë, e falënderon All-llahun xh.sh. dhe mbetet i kënaqur.”

All-llahu i lartësuar ka thënë:

“Kush nuk është i kënaqur me vendimin T`im dhe nuk duron në vuajtje, le të kërkojë Zot tjetër përveç Meje!”

“Kur robi Im do të afrohet, edhe Unë dua t`i afrohem, ndërsa, kur ai nuk do të Më afrohet Unë nuk dua t`i afrohem.”

(Hadithi Kudsij – Përmbledhjet e haditheve, Maliku, Buhariu, Nesaiu)

Dhembja është me vlerë dhe vuajtja ka kuptim

Sprova dhe dhembjet kanë qenë shoqëruese të vazhdueshme të njeriut që nga zanafilla e tij. Gjermanët e vjetër këtë të vërtetë që atëherë e shprehën me fjalët: “Jeta është vuajtje”. Edhe feja islame nuk e përjashtoi sprovën nga jeta dhe zemrat e njerëzve. Përkundrazi, islamu tregoi se sprova është një fakt i rëndësishëm për çdo njeri, është e çmueshme dhe e dobishme, pavarësisht se është përplot me dhembje e sakrifica.

Përveç kësaj, është me rëndësi të theksohet se sprova është një provokim i madh, por edhe një provim i vështirë për çdo besimtar dhe askush nuk e di paraprakisht si do të kalojë në atë provim.

Prandaj, në parim nuk duhet të dëshirohet as të kërkohet sprova, sepse vetëm All-llahu xh.sh. është kompetent për qëllimin, shkakun dhe caktimin, kur dhe kujt do t’ia dërgojë atë dhe në ç’shikallë intensiteti. Mirëpo, pikërisht për këtë arsye, kur të vijë sprova, sado që të jetë e vështirë, duhet ta pranojmë me besim, me guxim, duhet ta pranojmë si përcaktim (Kader) i dhënë nga Zoti xh.sh.

Në dhembjen e sprovës duhet të mësojmë, tek ajo duhet të kërkojmë kuptimin e jetës dhe atë duhet ta shfrytëzojmë për përparimin shpirtëror. Nga sprova duhet të marrim mësim.

Njëkohësisht duhet të përpiqemi që të dalim nga ajo sa më shpejt dhe sa me më pak dhembje.

Përmes kësaj përvoje të vlefshme njeriu duhet të çelikosë shpirtin me besim, në mënyrë që zemra e tij e mbushur me Emrin dhe Porosinë e All-llahut xh.sh. të bëhet shkëmb, mbi të cilin do të përplasen valët më të mëdha dhe më të fuqishme të sprovës në sëmundje, vuajtje e në mundime.

Por njeriu shpesh tregohet i dobët, i padurueshëm dhe, posa të fillojnë vështirësitë, ia behin pyetjet: “Përse vuajtje, sëmundje, përse të mos kemi gjithmonë gëzim, lumturi të përjetshme, jetë pa sprovë?” Njeriu duhet ta dijë se rrugët tona, drejt të cilave na udhëzon All-llahu xh.sh., janë të panjohura, por gjithashtu duhet të dijë që Zoti xh.sh. bën për ne gjithnjë vetëm atë që është e mirë. Gjykimet tona janë të kufizuara dhe ne nuk mund t’i kuptojmë në tërësi ballafaqimet tona me të mirën dhe me të keqen. Nganjëherë dëshirojmë diçka me pasion duke menduar se ajo është e mirë, ndërsa pikërisht nga ajo lind e keqja. Herën tjetër largohemi nga diçka për të cilën mendojmë se nuk është e mirë, ndërsa pikërisht ajo rezulton si e mira e vërtetë.

Prandaj All-llahu xh.sh. i porositi njerëzit: *“Ndodh që ju e urreni një gjë, por ajo mund të jetë e mirë për ju dhe ndodh që ju e doni një gjë, por ajo është e dëmshme për ju. All-llahu e di, ju nuk e dini.”* (El-Bekare (2): 216)

Kjo e vërtetë është dëshmuar dhe vërtetuar gjatë sprovave, vuajtjeve, sëmundjeve dhe në të gjitha ato gjëra që na duken të vështira në jetë.

Ndoshta Zoti i Dashur nëpërmjet dhembjes dëshiron që ne të pastrohemi nga gjynahet e kalaura dhe ashtu të pastër të shkojmë në botën Tjetër. Mbase na përgatit që të kalitur në zjarrin e sprovës, të forcuar dhe trimërisht të presim të gatshëm ndonjë sprovë edhe më

të madhe, për të cilën Ai e di se vjen. Ndoshta na ndëshkon për shkak të gjynaheve ose na paralajmëron që të mos gabojmë më. E mbase përmes dhembjeve të përballuara me besim na i përgatit shkallët më të larta në xhennet.

Është me rëndësi që në ato momente, për ne ndoshta të vështira, por të rëndësishme, të qëndrojmë në besim të fuqishëm e të pathyeshëm dhe t'i bindemi me gjithë zemër Vullnetit të Zotit xh.sh.

Është e vërtetë e lashtë që vlera e njeriut dëshmohet në zjarrin e dhembjes. Dhembja i ndan trimat moralisht të fuqishëm nga të dobët dhe të ngathët. Romakët e vjetër u thoshin të vuajturve dhe të sëmurëve: “Përballlo!”, që me trimërinë tënde të jesh shembull për të tjerët. Ndërsa besimtari i thotë besimtarit: “Përballlo me besim dhe bindje tek Zoti!” – me qëllim që të bëhesh pishtar, dritë e fesë (besimit) në momentet më të vështira, madje edhe në çastin e vdekjes së trishtuar të bëhesh mësues në rrugën e së Mirës.

Një fjalë e urtë romake thotë:

“Ari provohet në zjarr, kurse trimi në ditët e vështira!”

Në vuajtjen e përballuar njerëzore Melekët thurin fije ari të jetës së njeriut, fije kurajimi, durimi dhe dinjiteti, të gatshëm që atë qëndisimë të shkëlqyeshme t’ia paraqesin Zotit xh.sh. në formën më të bukur.

Një i urtë ka thënë: “Kush e ka ruajtur edhe pas dhembjes besimin në Providencën e Zotit xh.sh., atij nuk mund t’i bëjnë asgjë goditjet e fatkeqësive. “Fjalët e lutjes së tij kanë qenë: “Rrugët e sheshta, në të cilat me pak përpjekje mund të shkohet larg dhe ato shtigjet e qeta, të cilat i kërkojnë me pasion shumë njerëz, le të jenë për të tjerët. Mua, o Zot i Plotfuqishëm, ma jep shtegun me pamje të bukur (perspektivë), shtegun, i cili

gjithmonë të çon përpjetë, me të cilin mund të përparoj, i bindur se nuk do të lajthis.”

Gjëja më e rëndësishme për besimtarin është të kuptuarit që Zoti i Dashur është i Mirë dhe i Mëshirshëm pa masë dhe se çdo njeriu të mirë i dëshiron dhe i dhuron gjithmonë vetëm të mira. Edhe në vuajtjet e dhembjes, dhuratat e Tij janë të shumëfishta dhe jashtëzakonisht të çmuara. Disa do të na bëhen të qarta (të njohura) më vonë, ndërsa disa prej tyre i njohim që tani...

Duke përjetuar dhembjen kuptojmë vlerën e jetës pa vuajtje. Humbja e ëndrrës flet për bukurinë e saj. Shumë njerëz vetëm atëherë kur bien në shtratin e të sëmurëve e kuptojnë të vërtetën mbi vlerën e dhuratave të Zotit xh.sh.. Derisa ishin shëndoshë, nuk kanë ditur t'i kuptojnë dhe t'i vlerësojnë sa duhet. Të kuptuarit e këtyre gjërave i nxit zemrat e njerëzve të shprehen: Faleminderit, o Zot, që na ke përfshirë me Mëshirën Tënde, faleminderit që na bërë të mundur të kuptojmë të vërtetën dhe sekretin e krijimit.

All-llahu xh.sh. kurrë nuk i braktis njerëzit e mirë, Ai gjithmonë u sjell ngushëllime duke ua kompensuar edhe në këtë botë atë që e kanë humbur. Rrugët e Mëshirës së Zotit xh.sh. janë të pakufishme.

Vuajtja dhe sprova kthjellojnë mendjen, largojnë errësirën, sqarojnë tisin e arsyes, zgjerojnë horizontin e pamjes. Në këtë mënyrë zemra jonë i kupton më qartë se asnjëherë më parë bukuritë e besimit dhe fuqinë e zjarrit të tij të panjohur deri atëherë.

Gjatë sëmundjes dhe vuajtjes lirohen prangat trupore, dobësohet trupi, por forcohet shpirti duke synuar lart e më lart drejt Krijuesit të vet. Të gjitha teket materiale në çastet e ngritjes shpirtërore qartësohen me gjithë bukuritë e tyre dhe shpallen si e vetmja e vërtetë. Interesi

për çdo gjë materiale zbehet, ndërsa forcohen synimet dhe aspiratat e mira dhe fisnike të shpirtit tonë.

Për besimtarin gjatë sprovës dhe vuajtjes hapen dyert e jetës shpirtërore dhe të njohurive më të mëdha shpirtërore, të cilat, sikur të mos ishte sëmundja, nuk do të mund të realizoheshin në nivel aq të lartë. Mbase All-llahu xh.sh., pikërisht nëpërmjet kësaj rruge ka dashur ta shpërblejë besimtarin me njohuri të shkëlqyera, të cilat as që ka mundur t'i imagjinojë. Shumë mendime, njohuri deri atëherë të qëndrueshme, tani paraqiten me një dritë tjetër.

Shumë njerëz, pikërisht gjatë sëmundjes, përmes vuajtjes, e kanë njohur dhe e kanë kuptuar ekzistencën e Zotit xh.sh.

Adolf Retle (Drejt dritës së amshuar, 1916), duke folur për sëmundjen tha se në botë do të zotëronte vetëm e keqja dhe krimi, sikur të mos na afronte Zoti nga Vetja edhe me sëmundjet tona, prandaj lavdi Zotit që lejoi të vijë sëmundja tek unë.¹

Gjatë sprovës ndodhin mrekullira. Vlerat e fshehta shpirtërore të ngecura dikund, ndjenjat tona të mira, filantropizmi që ndoshta kanë qenë larg nesh për shkak të rendjes sonë pas parasë dhe kënaqësive, tani paraqiten me bukurinë e tyre të plotë.

Pejgamberi a.s. ka thënë:

“All-llahu i lartësuar i çon sprova të llojllojshme robit të Vet të devotshëm, në mënyrë që ta pastrojë nga gjynahet.”

Zemra jonë e sëmurë zgjerohet që me forcën e madhe të dashurisë të mbështjellë çdo njeri me pelerinën e vet. Buzëqeshja e të sëmurit në kuptimin shpirtëror fiton përmasa, të cilat buzëqeshja e njeriut të shëndoshë nuk

1 B. Vučo, Fragment i shkëputur nga libri: “Odrana moga vjeronanja”, Makarska, 1976.

mund t'i ketë asnjëherë. Hapen gjerë e gjatë dyert e shpirtërores dhe të seriozitetit përballë sekretit të jetës, vuajtjes e vdekjes.

Të kuptuarit që jeta nuk është vetëm kënaqësi të nxit në mendime më intensive mbi kuptimin, fillimin dhe përfundimin e saj të pashmangshëm. Të gjitha këto përjetohen më thellë sesa kur njeriu është plotësisht i shëndoshë.

Këto mendime, me siguri nxisin idenë mbi Zotin Krijues. Ngjarjet e mrekullueshme gjatë sëmundjes deri në shërim ose deri në vdekje, në atë freskoren e gjerë të ndodhive, sikur e lajmërojnë qartë Qenien dhe Ekzistencën e Zotit xh.sh. Ato mendime janë pasuria më e madhe në zemrën e besimtarit dhe për të nuk ka njohuri më të mira dhe arritje më të larta shpirtërore. E, ky pra është shpërblimi më i madh për besimtarin! Ka mësuar besimtari për çështje të besimit, për dëshminë e besimit dhe e ka dëshmuar me fjalën: “Besoj”. Kjo dëshmi tani kërkon seriozitet të plotë. Ajo bëhet e njohur në mënyrë të qartë në zemrën e besimtarit, ndërsa të kuptuarit që me siguri është Dikush mbi ne, mbi çdo gjë të kësaj bote, Dikush i Gjithëpushtetshëm dhe i Gjithëmëshirshëm, bëhet realitet i pakundërshtueshëm.

Besimtarit të mirë dhe të devotshëm Zoti i Dashur, i sjell ngushëllimin plot shpresa. Që të dyja vijnë me siguri, pikërisht ashtu si është më mirë për ne. Gjithashtu shpërblim i madh për besimtarët është mëshira e Zotit xh.sh. që ia jep atij për dëshminë e besimit gjatë vuajtjes e dhembjes. Dëshmia e tij vjen nga thellësitë e zemrës dhe shprehet në komunikim të qetë me All-llahun xh.sh.:

“E dëshmoj, o Zoti im, besimin tim edhe përmes vuajtjes së përballuar me durim e kurajo, e dëshmoj nëpërmjet dhembjes së përmbajtur, e dëshmoj, të dorëzohem Ty dhe i nënshtrohem Vullnetit dhe Përcaktimit

Tënd. E pranoj çdo gjë që e dëshiron Ti dhe çdo gjë që e jep Ti, e pranoj pra, edhe këtë dhembje duke qenë plotësisht i vetëdijshëm se ajo ka ardhur me Vullnetin Tënd, e Vullneti Yt për mua është çdo gjë.”

Dhe besimtari e ndien në dëshminë e tij të besimit që të gjitha psherëtimat e lëshuara gjatë vuajtjes, me siguri do t'i shërbejnë për të mirë, tani e gjithnjë, madje edhe në amshim.

Pranë shtratit të të sëmurit radhiten të dashurit dhe të afërmit: i ati, e ëma, bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët, motrat, kushërinjtë, miqtë etj. Të gjithë vijnë e shkojnë. Nganjëherë rrinë më gjatë e herë më shkurt. Ata të gjithë janë të brengosur dhe dëshirojnë t'i ndihmojnë të afërmit të tyre në dhembjen e tij. Megjithatë, nganjëherë, të paktën për një moment, të sëmurit i duket se është i vetmuar dhe i braktisur, sepse të gjithë, sado që janë të dashur dhe të afërm, janë njerëz me problemet, hallat dhe punët e tyre. Besimtari i vërtetë e di me siguri se nuk është i vetëm. Zoti xh.sh. e bëri të njohur dhe e shpalli praninë e Tij:

“Dhe kur të të pyesin robtë e mi për Mua,

Unë jam me të vërtetë afër...” (El-Bekare (2): 186).

Prandaj është i madh gëzimi i besimtarit, sepse e di që jeton, vuan dhe vdes në praninë e Zotit xh.sh.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“All-llahu i lartësuar thotë: “O robi Im, Unë jam me Ty, sa herë të më përkujtosh dhe kudo që më përmend!”

“All-llahu i lartësuar thotë: Unë jam pranë robit Tim, kudo që më përmend dhe deri sa ai lëviz buzët e veta me dhikër.”

“All-llahu i lartësuar do të thotë në ditën e Gjykimit: “O njeri! Unë kam qenë i sëmurë, e ti nuk më ke vizituar? Ti nuk ke vend! All-llahu do t'i thotë: Vallë, nuk e ke ditur që robi Im ka qenë i sëmurë e ti nuk e ke vizituar?”

A e di ti, po ta kishe vizituar atë njeri, Mua do të më kishe gjetur tek ai!”²

Në praninë e All-llahut të Dashur njeriut i forcohet besimi, i rriten fuqitë shpirtërore në përmasa të paimagjinueshme dhe pastaj, sikur fillojnë e i zhduken dhembjet dhe vuajtjet e sëmundjes. All-llahu xh.sh. dhembjen e përballuar me besim e shpërblen në të dy botët. Umu-l-A’la ka treguar: “Më ka vizituar Pejgamberi i All-llahut (SAV) kur isha e sëmure. Ai atëherë më tha: Umu-l-A’laji e gëzuar, sepse një muslimane e cila vuan dhe e përballon atë me durim, All-llahu xh.sh. e pastron nga gjynahet, sikurse e pastron zjarri argjendin nga ndryshku.”

Hasan Basriu ka thënë: “Sëmundja e pastron trupin, siç e pastron zekati pasurinë. Një trup që nuk di ç’është sëmundja, është si pasuria e cila nuk pastrohet me zekat, tek ai nuk ka përparim.”

Xhelaludin Rumi shkruan në “Mesnevi”:

“Gjatë kobës së sëmundjes na pushton hidhërimi, vaji e pendim?”.

Koha e sëmundjes është periudha e zgjimit shpirtëror.

Kur njeriu sëmuret, i lutet Zotit për falje.

Gjatë sëmundjes njeriu mendon më kthjellët dhe gjykon më mirë.

Ty, o njeri, vetëm sëmundja ta tregon

Tërë shëmtinë e gjynahit tënd.

Dbe ti atëherë merr vendim;

Do të kthehem në rrugë të drejtë!

Besën ti atëherë e jep dhe betobesh:

Që tani, sapo të shëndoshem,

Zgjidhje tjetër për mua nuk ka,

Përveç Zotit të Dashur t’i nënshtrohem.

Sëmundja ty të vërtetën ta zbuloi

² Këtë hadith e përmend Muslimi, kurse e ka transmetuar Ebu Hurejre.

*Përmes sëmundjes, arsyes dhe mendjes ta çoi,
Urtësinë Ai ta ktheu.
Që të përgjigjesh dhe vetëdijën ta fitosh,
E kur All-llahu mysafirin (sëmundjen) ta çon,
Përse atë ti nuk e pranon(!)''*

Në vargun e vlerave të dhembjes së përballuar me sabër dhe fytyrë të gëzuar është edhe shpërblimi në botën Tjetër, të cilin All-llahu xh.sh. ia jep të sprovuarit nga bollëku i Mirësisë së Vet. Çdo psherëtimë e dhembjes, çdo sekondë e gjëmës së përmbajtur dhe çdo lot i gëlltitur sjell shpërblim të madh në xhennet, në pjesët më të bukura të xhennetit.

Çdo ditë, çdo orë e të sëmurit, që vuan nga dhembjet, çdo ditë orë e të sëmurit të gjymtuar, të paralizuar, të verbër ose e të sëmurit, i cili në cilëndo formë është privuar nga jeta normale dhe e shëndoshë, japin fryte të paçmuara në Ahiret. Ajo vuajtje në fe është rruga më e mirë, që shpie drejt dverve të hapura anekënd vandbanimit në xhennet.

Muhammedi a.s. thotë:

“Krijuesi i lartësuar ka thënë: “Kur e vë në provë njeriun me sëmundje dhe ai më shpreh falënderim dhe duron, do të ngrihet nga shtrati pa gjynahe, sikur e ka lindur e ëma”.

Krijuesi do t’ju thotë melekëve, shoqëruesve të njeriut:

“Këtë njeri e kam penguar nga ibadeti dhe e kam vënë në provë (me sëmundje). Shkruajani shpërblimet, sikurse do t’ia shkruanit po të ishte i shëndoshë. “(Përmbledhje hadithesh – Ahmedi).

Pejgamberi i Zotit e vizitoi një të sëmurë dhe i tha:

“Ji i gëzuar, sepse All-llahu xh.sh. ka thënë: “Sëmundja është zjarri im, ia jap robit Tim besimtar në këtë botë, që ta

ketë në mbrojtje nga zjarri i ditës së Gjykimit... (Përmbledhjet e haditheve: Ahmedi, Ibn-Maxhe, Bejhikiu).

Krijuesi i lartësuar ka thënë: “Nuk do ta nxjerr nga kjo botë asnjë prej atyre të cilëve dua t’ua fali gjynahet që i kanë në qafë, derisa kjo nuk plotësohet me sëmundjen e trupit ose me skamje në furnizim.” (Përmbledhja e haditheve: Razim).

Krijuesi i lartësuar ka thënë: “Kur e vë në sprovë (me sëmundje) robin Tim dhe ai nuk u ankohet në Mua atyre të cilët e vizitojnë, e heq nga ai sprovën, pastaj ia zëvendësoj mishin me mish më të mirë, e gjakun me gjak më të mirë i jap shëndet më të mirë) dhe ai fillon përsëri të punojë (shërohet).” (Përmbledhjet e haditheve: Hakimi dhe Bejhikiu).

“Do të vijnë disa njerëz në Ditën e Gjykimit dhe All-llahu xh.sh. do t’iu kërkojë ndjesë atyre, sikur ne justifikohemi para njerëzve. All-llahu xh.sh. do të thotë: “O robi Im, *Unë nuk të kam lënë të vuash* në këtë botë, për shkak se të kam harruar, por kam përgatitur për ty diçka që do të ta jap tani këtu.”

“All-llahu i lartësuar më ka porositur: “Në qoftë se robit Tim i dhembin sytë dhe ai përballon me durim, Unë do t’ia shpërblej durimin e tij në xhennet.”

“Me të vërtetë, njerëzve të mirë u ndodhin probleme dhe fatkeqësi në jetë. Por, pa dyshim, besimtarit nuk do t’i ndodhë asnjë fatkeqësi, madje as sa e shpuara e ferrës e që për shkak të saj të mos i falet një gjynah dhe të mos i rritet dinjiteti tek All-llahu për një shkallë.”

Ndër dhuratat e All-llahut xh.sh., të njohura e të panjohura për ne, është pozita e të sëmurit. Për shkak të përballimit me kurajo të sprovës dhe të durimit trimëror të dhembjes, ajo rritet në kuptimin shpirtëror në shkallë të larta, me të cilat All-llahu xh.sh. është i kënaqur. Pozita e tyre rritet në shkallë aq të larta, saqë Pejgamberi a.s.

në një rast tha: “Kur të shkosh tek i sëmuri, kërko nga ai që t’i lutet Zotit për ty, sepse lutja e tij është baras me lutjen e melekëve.” Lutja e të sëmurit bën pjesë në ato lutje, të cilat All-llahu xh.sh. i pranon dhe i plotëson me kënaqësi.

Vlera e të sëmurit tek All-llahu xh.sh. shtrihet edhe në rrethin e të sëmurit. Melekët u dhurojnë çaste të shkëlqyera atyre të cilët janë pranë të sëmurit dhe e përcjellin me kujdes rrjedhën e sëmundjes, atyre që e ndihmojnë, vizitojnë dhe e mjekojnë atë.

Muhammedi a.s. ka thënë: “Kush i viziton të sëmuret noton nëpër Mëshirën e All-llahut e, kur të ulet pranë të sëmurit, i tëri zhytet në Mëshirën e Dashurinë e All-llahut xh.sh.”

Janë të mrekullueshme ato dhurata të Zotit xh.sh. të cilat u ofrohen besimtarëve.

Pranë të sëmurit pastrohen gjynahet, nëpër dhomën e të sëmurit fryn erë rahmeti. Të gjitha rrugët të cilat të shpien nga i sëmuri, janë rrugët e mirësisë. Gjithkund ndihet Mëshira e Zotit xh.sh. Dhoma e të sëmurit i fisnikëron në mënyrë misterioze zemrat e njerëzve. Aty me bollëk shpërndahen dhuratat shpirtërore, si për të sëmurin, ashtu edhe për ata të cilët janë pranë tij, sikur është paradhomë xhenneti.

E në qoftë se sëmuren ata të cilët i mjekojnë të sëmuret, duke e marrë sëmundjen e të mjekuarve, për ngri-tjet e tyre shpirtërore sikur nuk ka kufij, sepse me vetëdije dhe vetëmohim e flijojnë shëndetin e ndoshta edhe jetën e tyre, që t’i ndihmojnë vëllait të tyre, njeriut të mirë. Dhe për të gjithë ata të cilët duke u bërë mirë njerëzve, duke u ndihmuar dhe duke u bërë shkak për shpëtimin e tyre e flijojnë shëndetin e vet, me siguri do t’i kenë, me lejën e All-llahut xh.sh. të hapura dyert e madje edhe hapësirat e xhennetit.

Me qëllim që jeta të ketë kuptim më të thellë, bukuri të veçanta, vlera të mëdha shpirtërore të përjetuara fuqishëm, me qëllim që të bëhen më të qarta horizontet e të vërtetave të mëdha sekrete, me qëllim që shpërblimi në të dy botët të përjetohet sa më fuqishëm, sa më mirë dhe sa më shumë, All-llahu (Qoftë madhëruar Emri i Tij) ka përcaktuar rrugë të shumta misterioze të dhembjes, sëmundjes, vuajtjes dhe provës. Kjo është rruga përmes së cilës All-llahu xh.sh. i zgjodhi besimtarët e vërtetë dhe të besueshëm, të cilët deri në pakufi janë besnikë ndaj Tij, ndaj Krijuesit të Shenjtë.

All-llahu na thërret në lutje

Zoti, Krijuesi ynë i Mirë na thërret vazhdimisht në lutje, kur jemi shëndoshë e të gëzuar, por edhe gjatë sprovës kur jemi katandisur keq nga dhembjet. Ai këtë e bën për të na ndihmuar dhe për të na dhuruar ilaçin e vërtetë. Zoti xh.sh. i thërret të gjithë ata të cilët derdhin lot t'i drejtohen Atij, që Ai me ngushëllimin e Tij t'i fshijë lotët nga fytyrat e dëshpëruara, Zoti xh.sh. i thërret të gjithë ata të cilët dridhen nga përfundimi i dhembshëm t'i drejtohen Atij, që Ai t'u japë qetësi. Ai thërret të gjithë ata që kalojnë rrugë të vështira të kësaj bote dhe shkojnë në ballafaqim me botën tjetër t'i drejtohen me lutje Atij, që Ai t'ua tregojë rrugën e shpëtimit. Dhe për të gjitha fatkeqësitë që mund t'i ndodhin njeriut, ngushëllimi i vetëm dhe i plotë është All-llahu xh.sh.. Besimtari e ndien thellë gjatë vuajtjes se ka nevojë për Zotin, aq sa ka nevojë për ajrin dhe ujin. E tërë gjithësia është plot me Mëshirë dhe dashuri të Zotit xh.sh., të cilën Ai dëshiron t'ua japë atyre që i luten Atij. E Mëshira dhe Dashuria e Zotit xh.sh. mund të bëjnë për ne shumë më tepër se të gjitha përpjekjet tona. Lutja u jep siguri të plotë të gjithë atyre që janë në vuajtje dhe sprovë.

Zoti xh.sh. thërret për bisedë të qetë në vetmi, thërret në lutje, e cila është frymëzuese e paqes dhe e fuqive kolosale shpirtërore aq shumë të nevojshme për të dobëtit. Në këto momente hapen dyert e Mëshirës së Zotit xh.sh. për zemrat e njerëzve dhe zbulohen thesaret e je-

tës shpirtërore. Lutja e forcon shpirtin, e forcon edhe trupin dhe jep shpresë për shpëtim nga vuajtjet dhe dhembjet.

All-llahu xh.sh. dëshiron dhe mund të bëjë që nga çdo gjë që na mundon, madje edhe nga e keqja më e madhe të lindë e mira dhe shpëtimi për ne. Çfarëdo qofshin shqetësimet, tmerret, hidhërimet, ne kemi Bamirësin e sigurt. Ai, Miku ynë më i madh, nuk do të lejojë asnjëherë të vijmë në pozitë aq të vështirë, nga e cila Ai nuk do të dëshironte të na shpëtonte. Mirëpo tani Ai kërkon përpjekjen tonë, që me lutje t'i forcojmë mundësitë tona shpirtërore, të cilat na japin mbështetje të pakufishme tek Ai, e kjo largon çdo frikë nga e panjohura. Zotin xh.sh. e gëzojnë lutjet e sinqerta dhe me kënaqësi u përgjigjet atyre.

“E kur robtë e Mi të pyesin ty për Mua, unë jam afër, i përgjigjem lutjes së atij që më lutet. Prandaj, le t'i përgjigjen ata thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, që të jenë në rrugë të drejtë.”
(El-Bekare (2): 186)

“Lutjuni Zotit me përulje dhe në beshtje, sepse Ai nuk i do ata të cilët e teprojnë. Dhe mos bëni rrëmujë në tokë, pasi që në të është vënë rregulli dhe Atij lutjuni me frikë dhe shpresë të madhe. S'ka dyshim se mëshira e All-llabut është pranë besimtarëve”.
(El-A'raf (7): 55-56)

“Zoti juaj ka thënë: “Më thërrisni, se Unë do t'ju përgjigjem.” (El-Mu'aminu (40): 60).

Lutja ka qenë traditë e të gjithë pejgamberëve të Zotit xh.sh. dhe muslimanëve të mirë. Ata i janë drejtuar me lutje All-llahut dhe e kanë kërkuar ndihmën e Tij. Kanë marrë forcë nga lutja e cila ka ngadhënjyer mbi çdo vuajtje të kësaj bote.

Muhammedi a.s. për lutjen ka thënë:

- “Asgjë s'mund ta ndërrojë fatin e njeriut përveç lutjes.”

- “Zoti është... fisnik dhe, kur njeriu i çon duart lart, Ai turpërohet që t’ia kthejë të zbrazëta, pa shpresë”.

“Kërkoni nga All-llahu t’ju falë dhe t’ju dhurojë shëndet (e mirëqenie) në të dy botët”.

- “Midis katër lutjeve, të cilat nuk do të refuzohen është edhe lutja e të sëmurit deri sa nuk shërohet”.

- “Kush do që Zoti t’i përgjigjet kur është në halle dhe vështirësi, le t’i lutet shumë Zotit, kur është në rehati”.

Për t’u pranuar tek All-llahu xh.sh. ajo duhet të dalë nga thellësia e zemrës së besimtarit, nga zemra e stërmbushur me besim dhe mbështetje te All-llahu xh.sh. Lutja duhet patjetër të jetë e sinqertë, me zemër plotësisht të hapur dhe të bindur ndaj All-llahut xh.sh. Besimi duhet të përshkojë tërë qenien e njeriut dhe forca e tij duhet të shkëlqejë rreze të plota drite në çdo veprim dhe fjalë të tij.

Gjatë lutjes njeriu e ndien afërsinë dhe ndihmën e All-llahut xh.sh. e cila vjen me siguri. Shumë gjëra që në rrethana të tjera do të ishin mrekulli, pas lutjes bëhen realitet.

“Çdo muslimani që kërkon ndonjë dëshirë nga All-llahu, e cila nuk përmban në vete gjynah dhe shkëputje të lidhjeve farefisnore, Zoti xh.sh. ia jep njëren nga këto tri gjëra: ose ia plotëson dëshirën menjëherë, ose ia shtyn për botën e ardhshme, ose e mbron nga e keqja e ngjashme (me atë sipër)”. (Hadith).

Lutja është më e mirë të bëhet pas namazit, në ditë dhe net të bekuara, në vendet e rëndësishme të islamit. All-llahu xh.sh. me kënaqësi e pranon lutjen e besimtarit, që gjendet në vështirësi, lutjen e prindit të mirë për fëmijët e mirë, lutjen e fëmijëve të mirë për prindërit, lutjen e udhëtarit, pendestarit, etj.

All-llahu xh.sh. thotë: “Jam i hidhëruar me atë që nuk më lutet.” (Hadithi Kudsi).

Duhet t'i lutemi All-llahut xh. sh.

Lutja e besimtarit drejtuar All-llahut xh.sh. është rrugë drejt shpëtimit dhe lumturisë, prandaj duhet t'i lutemi All-llahut xh.sh. duke besuar në ndihmën e Tij, duhet t'i lutemi pandërprerje. Qëndrueshmëria në lutje është një nga kushtet, që ajo të pranohet. Nuk duhet të ketë dekurajime dhe abstenime. Ndërhyrja e Zotit xh.sh. nuk ndodh patjetër po në atë moment. Ejubi a.s. me vite të tëra e ka përballuar sëmundjen dhe mjerimin e tij material me durim dhe asnjëherë nuk i ka ndalur lutjet drejtuar All-llahut xh.sh. Sa më me këmbëngulje, sa më me ngrohtësi dhe sa më me përzemërsi të lutemi, aq më afër Mëshirës së Zotit do të jemi.

Me Zotin e Mirë e të Mëshirshëm mund të takohe- mi në çdo moment, çdo ditë e natë, çdo orë, minutë e sekondë, kur të dëshirojmë – tani e gjithnjë. Kur i drejtohem Zotit me lutje, shpërndahen perdet misterioze dhe Zoti i flet në mënyrë të çuditshme zemrës njerëzore. Zoti, pa masë i Mirë, e dëgjon pikëllimin tonë dhe durimi, ndjeshmëria e kujdesi i Tij për ne janë të plotë. Këtë e bën për dobinë tonë dhe pikërisht ashtu si është më e dobishme për ne. Ndihma dhe ngushëllimi i tij vijnë në formën që e dëshiron Ai, si e gjykon Ai se është më e drejtë. Nganjëherë, jo ashtu si do ta dëshironim ne për një moment, por me siguri, plotësisht e sigurt, atëherë dhe ashtu si është më e mirë për ne. Mirësia e Tij e pakufishme vigjilon gjithmonë mbi ne. Veprimi i Tij

është misterioz, i mrekullueshëm, i mbinatyrshtë, por gjithnjë shpëtimtar. Zoti xh.sh. asnjëherë nuk e pengon atë që është e mirë dhe shpëtimtare për ne.

All-llahu xh.sh. u përgjigjet atyre që i luten, u ndihmon në lutjet e arsyeshme dhe ua largon vështirësitë, vuajtjet dhe dhembjet. Zoti xh.sh. na do. Ne jemi të sigurt se Ai do ta dërgojë Mëshirën e Vet. Ndihma e All-llahut xh.sh. është e pranishme edhe gjatë shërimit të mrekullueshëm të trupit dhe të shpirtit tonë.

Madje, edhe të sëmurët e pashërueshëm sipas kriteve njerëzore me anën e lutjes marrin lehtësi fizike e shpirtërore.

All-llahut xh.sh. duhet t'i lutemi, por lutja duhet të na nxitë për veprime personale për largimin e vështirësive për aq sa kemi mundësi.

S'është për t'u çuditur që Zoti xh.sh., duke mos i tejkaluar dhe duke mos i shkelur kufijtë e ligjeve natyrore, mund t'i shpejtojë deri në maksimum proceset e të shëruarit, duke stimuluar mundësi të papritura brenda organizmit tonë, për të cilat as që kemi ditur që ekzistojnë. Ato procese të stimuluar mund të jenë më shpëtimtare se çfarëdo ilaçi fizik.

Shërimet e jashtëzakonshme të cilat për ne nganjëherë duken të çuditshme (si p.sh. tërheqja spontane e karcinomit dhe zhdukja e tij) nuk janë kurrfarë shkeljeje e ligjeve natyrore. Ato janë shenjë e All-llahut xh.sh. që ua dërgon atyre të cilët janë shpërblyer me shërim dhe atyre që janë të pranishëm në atë shërim. Nganjëherë nuk duket aspak i çuditshëm ky proces dhe proceset e ngjashme si ky, përveç kur ndodh rast i pazakonshëm në trajtimin e rregullt të shërimit. Zoti xh.sh. shfaqet në vepra të këtilla dhe i nxit për meditim dhe ecje drejt besimit ata që janë pjesëmarrës në atë ndodhi. Ai njëkohë-

sisht e shfaq praninë e Tij qartë, shpeshëherë krejtësisht qartë para shumë njerëzve, të cilët shikojnë me shpirt.

Kur’ani flet se si Ejubi a.s., i sëmurë rëndë, me vullnetin e All-llahut xh.sh. u shërua, se si Jakubi a.s., i verbër, me vullnetin e All-llahut xh.sh. në mënyrë të çuditshme dhe papritmas filloi të shohë, se si gruaja e Ibrahimit a.s., me vullnetin e All-llahut xh.sh., ndonëse në pleqëri të thellë lindi djalë.

Ja rrëfimi kur’anor mbi shërimin e gruas së Zekerijaut a.s.:

“(Përkujto) Edhe Zekerijau kur e luti Zotin e vet: “Zoti im, mos më lër të vetmuar, se Ti je më i miri trashëgues. Ne ia pranuan lutjen e tij dhe duke ia shëruar bashkëshorten i dburuan Jabjain. Ata bënëin gara, që të bëjnë sa më shumë vepra të mira dhe Ne luteshim me shpresë dhe frikë dhe ndaj Nesh ishin të përvulur”. (El-Enbija (21): 89-90)

All-llahu xh.sh. i dha aftësi Isait a.s. që t’i shërojë njerëzit.

“Kur All-llahu tha: “O Isa, biri i Merjemës, përkujto dhuntitë e Mia ndaj teje dhe nënës sate;... kur me vullnetin Tim i shërove të verbërit dhe të gërbulanët dhe, kur me urdhërin Tim i ngjalle të vdekurit...” (El-Maide (5): 110).

Këto rrëfime kur’anore janë mësim dhe dije mbi gjithëfuqinë e All-llahut xh.sh., mësim dhe dije se si All-llahu xh.sh. u përgjigjet, u jep ndihmë, ngushëllim dhe shpëtim atyre që i luten Atij atëherë kur Ai dëshiron.

“Kur dëshirojmë ndonjë send, mjafton fjala jonë: “Bëhu!” dhe ajo bëhet. (En-Nahël (16): 40)

Rrugët e ndihmës së Zotit janë të shumënumërta...

Ndihma e Zotit xh. sh. vjen edhe atëherë kur humbim të gjitha shpresat e kësaj bote, kur nis dëshpërimi në zemrat tona, në mendimet tona, kur dhembja e trupit dhe shpirtit molis tërë qenien tonë.

Ngushëllimi i Tij vjen edhe atëherë kur terri i dëshpërimit nis t’i mbulojë horizontet e shpresave dhe të dëshirave

tona, kur e mbulojnë lotët fytyrën tonë dhe, kur duket se nuk ka ikje dhe shpëtim nga brengat dhe vështirësitë.

Shpesh, kur del fryma e fundit nga trupi i vuajtur, kur duket se jetës në këtë botë i ka ardhur fundi, kur vdekja është para nesh, lutja e drejtuar All-llahut xh.sh. na jep ngushëllim, qetësi, shpresë të madhe që i kalon kufijtë e të kuptuarit të kësaj bote, sepse... All-llahu i Mirë është Ai që jep furnizim me bollëk, i Cili zgjidh dhe hap rrugë, Zemërgjeri, i cili i pranon lutjet, Mbrojtësi dhe Bamirësi ynë. Ai është Shpresa e besimtarit, Ngushëllimi, Shpëtimi i tij! Ai është i vetmi tek i cili mund të mbështetet besimtari...

“Thuaj: Ai, All-llahu është Një! All-llahu është mbrojtësi i gjithkujt. As nuk ka lindur kënd, as nuk është i lindur. Dhe me Atë askush nuk mund të barazohet”. (El-Ihlas (112): 1-4)

Me emrin e Zotit në gojë dhe në zemër dhe me besim në vepra nuk ka frikë, pikëllim as dëshpërim.

Në çdo situatë, në çdo rast veç e veç, madje edhe në atë të dëshpërimit besimtari duhet t'i drejtohet All-llahut xh.sh. E kujt tjetër përveç Atij?

Kur paraliza fillon t'i asgjësojë qelizat nervore, kur muskujt nuk funksionojnë, kur ecja e gjallë dhe energjike bëhet ëndërr e kahershme, kur secila shkallë bëhet pengesë e pakapërcyeshme, kur nuk funksionojnë gishtat e duarve aq sa nuk mund ta mbajnë as lapsin, kur frymëmarrja bëhet e vështirë dhe e pamundshme, kur pamja e tmerrshme e agonisë së asfiksive e pushton kraharorin dhe, kur është bërë çdo gjë e mundur nga mjekësia bashkëkohore dhe përsëri në horizont nuk duket shpresa e shpëtimit, kujt t'i drejtohet besimtari për ndihmë, kujt tjetër, nëse jo Zotit të Dashur, Shpresës e Shpëtimit të vetëm...?

Kur infarkti e godet zemrën e njeriut dhe dhembja e tmerrshme e shqyen kockën e kraharorit duke e shtrënguar gabzherin sikur pinca, kur pikat e mëdha të djersës

së ftohtë kullojnë poshtë ballit dhe, kur frika lemeritëse e pushton çdo pjesë të qenies së njeriut, kujt t'ia drejtojë besimtari fjalët e veta, mbase të fundit? Kujt tjetër, nëse jo Zotit të Gjithëfuqishëm?

Kur tërmeti tund tokën, kur futet panik dhe, kur drithmat e frikës e shqyejnë njeriun – ku të ikë atëherë dhe kujt t'i drejtohet ai? Prej kujt do të kërkojë shpëtim atëherë besimtari? Vetëm prej Zotit të Madh – All-llahut xh.sh.! Sekondat atëherë janë të mbushura vetëm me lutje dhe mbizotëron jehona: “O ZOT, na shpëto, na mëshiro, ndale këtë lëvizje të tmerrshme të forcave të vrullshme të dheut...!”

Kur anija e peshkatarit në detin e shqetësuar, nën qiellin e vrenjtur, të errët e të zi, plot me shi, rrufe dhe erë uragani, me velat e shkatërruara dhe timonin e thyer, është gati të zhduket në valët e tërbuara të detit, kur fillon uji të arrijë deri në fyt, kur askund nuk ka asgjë në horizont përveç territ të zi e të dendur, kujt t'i drejtohet për ndihmë dhe shpëtim peshkatarit viktimë? Fjalët e tij janë: “O ZOT, Mëshiruesi im i vetëm, më shpëto, më kthe tek fëmijët e mi, më ruaj dhe më shpëto nga kjo fatkeqësi e madhe...”

Kur në djep digjet nga temperatura, i mbyll sytë e saj të lodhur, ndërsa krahërori çohet dhe lëshohet me shpejtësi dhe, kur buzët e nxira paralajmërojnë krizën e sëmundjes, kurse mjeku ka bërë të gjitha përpjekjet sa ka mundur dhe sa ka ditur, kë do të thërrasë nëna besimtare për ndihmë dhe shpëtim! Vetëm Zotin. Buzët e saj me devotshmëri lëvizin duke thënë: “Ja Rabbi, Ja Rabbi (O Zot, O Zot)...”

Nën patosin e besimit dhe kujdesin për fëmijën e saj, nëna i lutet Mikut të saj më të Madh për jetën e të dashurit. Dhe All-llahu xh.sh. është Ai që e dëgjon lutjen e nënës, i dëgjon psherëtimat e saj, e njeh dhembjen e fëmijës dhe pikëllimin e nënës dhe ia dërgon Mëshirën e Vet nënës së përplotur e të tmerruar...

Dhe shembujt e brengave dhe të pikëllimeve njerëzore do të rreshtoheshin pa kufi. Ndërsa besimtari edhe në momentet më të vështira, sado që është i dobët, me lutjen e tij dhe me kontaktin shpirtëror me All-llahun xh.sh., e ndien veten të denjë për shpresën për rrugëdalje dhe shpëtim. Greminat e dëshpërimit, frikës e drepresionit lindin me humbjen e shpresës së fundit, ndërsa zhduken nëpërmjet lutjes së drejtuar All-llahut xh.sh. dhe në vend të tyre në shpirt hyn qetësia.

“All-llahu nuk do të lejojë të humbë besimi (lutja) juaj. S’ka dyshim se All-llahu është shumë i butë dhe mëshirëplotë ndaj njerëzve”. (El-Bekare (2): 143)

Zemra e besimtarit në lutje rritet në fuqi shpirtërore dhe futet në esencën dhe bukurinë e lutjes. Ajo me fjalë të qeta flet me Zotin e vet: “Fal dhe mëshiro!” Besimtari me zemrën e tij bie në sexhde para Madhështisë së Zotit xh.sh., në dorëzim të plotë pa kurrfarë rezervash apo kushtesh. Ky është përkushtimi pa kufij dhe fund. Shpirti i tij e dëgjon të folurit e Zotit, i njohur vetëm për të dorëzuarit dhe të mirët. Dhe ai, të Folurit e Zotit, është plot me bukuri, dashuri, shpresë e ngushëllim të përjetshëm, të cilat i sjellin paqe shpirtit të vuajtur, e largojnë frikën dhe dëshpërimin.

All-llahu xh.sh. ka thënë:

“Le të mos frikësohen e të mos brengosen të dashurit e All-llahut, ata të cilët besojnë dhe ruben. Për ata ka përgëzime edhe në këtë jetë edhe në Ahiret. Premtimet e All-llahut nuk mundet askush t’i ndryshojë. Ky me të vërtetë do të jetë sukses i madh”. (Junus (10): 62-64)

“Thuaj: “Ai është Zoti im, nuk ka Zot tjetër përveç Atij, tek Ai jam mbështetur dhe Atij i drejtohem!” (Err-Rra’d (13): 30)

“Vetëm All-llahu i takon pushteti në qiej dhe në tokë dhe vetëm All-llahu ka mundësi për çdo send” (Ali Imran (3): 189)

Lutje për qetësim dhe ngushëllim

All-llahu xh.sh. shpalli në Kur'an edhe lutje për besimtarët, të cilat do t'u ndihmojnë atyre gjatë kohës së sprovës, vështirësive dhe vuajtjeve. Ja disa lutje kur'anore:

“Mbështetem tek All-llahu nga shejtani i mallkuar!”

“Me emrin e Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!”

“Falenderimi i takon vetëm All-llabut, zotit të botëve! Bami-rësit të përgjithshëm, Mëshirëplotit! Sunduesit të ditës së Gjykimit. Vetëm Ty të ardhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë!”

“Udhëzونا për në rrugë të drejtë! Në rrugën e atyre që i be-gatove me të mirat Tuaja, jo në rrugën e atyre me të cilët je hidhë-ruar e as të atyre që kanë humbur!” (El-Fatiha (1): 1-7).

“O Zoti ynë, prano prej nesh, sepse Ti me të vërtetë dëgjon dhe di çdo gjë”. (El-Bekare (2): 127)

“O Zoti ynë, na jep mirësi edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër dhe na ruaj prej dënimit me zjarr!” (El-Bekare (2): 201)

“O Zoti ynë, mos i lejo zemrat tona të largohen, pasi që na ke udhëzuar dhe na shpërble me mëshirën Tënde! Ti je me të vër-tetë shpërblyesi më i madh!” (Ali Imran (3): 8)

“O Zoti ynë, ne bëmë gjynah ndaj vetes dhe, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne me siguri do të jemi të humbur!” (El-A'raf (7): 23)

“Mua më mjafton All-llahu, nuk ka Zot tjetër përveç Atij; vetëm tek Ai kam mbështetje. Ai është Zoti i gjithësisë”. (Et-Tevbe (9): 129)

“O Krijues i qiejve dhe i Tokës, Ti je mbrojtësi im edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër. Ma merr shpirtin si musliman dhe më shoqëro me ata që janë të mirë”! (Jusuf (12): 101)

“O Zoti ynë, prano lutjen time!” (Ibrahim (14): 40)

“Dhe thuaj: “O Zoti im, bërë që të vdes duke qenë Ti i kënaqur me mua dhe bërë që të çohem nga të vdekurit duke qenë Ti i kënaqur me mua dhe më jep forcë nga ana Jote që do të më shërbejë si ndihmë”. (El-Isra (17): 80)

“Mua më gjeti fatkeqësia, kurse Ti je më i mëshirshmi nga të mëshirshmit”. (El-Enbija (21): 83)

“O Zoti im, mos më lër të vetmuar, se Ti je i vetmi i përjetshëm!” (El-Enbija (21): 83)

“O Zoti, unë Ty të drejtohem për mbrojtje nga vegimet e djallit dhe Ty, o Zot, të drejtohem të mos i kem pranë meje!” (El-Mu'minun (23): 9)

“Thuaj: O All-llahu im, që e ke tërë pushtetin, i jep pushtet kujt do Ti dhe ia merr kujt do. Ti e lartëson kë do dhe e poshtëron kë do, në dorën Tënde është çdo mirësi. Ti me të vërtetë ke mundësi për çdo gjë! Ti e lidh natën me ditën edhe ditën e lidh me natën. E krijon të gjallin nga i vdekuri, kurse të gjallin e bën të vdekur. Ti furnizon pa kufi atë që të do”. (Ali Imran (3): 26,27)

All-llahut xh.sh. duhet t'i lutemi edhe me emrat e Tij të bukur. Forca e pakufishme e besimit, shpresës, ngushëllimit buron nga kontakti misterioz i All-llahut xh.sh. me besimtarin. Njeriu as që mund ta imagjinojë se çfarë bukurish dhe mirësish të mrekullueshme dhe të dobishme mund të ndodhin për ne në ato momente.

“All-llahu ka emrat më të mirë, prandaj thirrreni dhe lutjuni me ata...” (El-A'raf (7): 190)

Emrat më të bukur dhe atributet e All-llahut xh. sh. janë:

1. I Gjithëmëshirshmi, 2. Mëshirëploti, 3. Sunduesi absolut, 4. I Shenjti, 5. Paqedhënësi, 6. Ai që i konfirmon premtimet, 7. Mbizotëruesi, 8. Fuqjploti, 9. I Gjithëfuqishmi, 10. I Madhërishmi, 11. Krijuesi i çdo gjëje, 12. Nismëtari i çdo krijese, 13. Formëdhënësi, 14. Ai që fal shumë, 15. Ai që mposht çdo gjë, 16. Ai që dhuron shumë, 17. Furnizuesi i pamasë, 18. Zgjidhëdhënësi, 18. I Gjithëdituri, 20. Shtërnguesi, 21. Ai që jep çdo gjë, 22. Ai që sjell begati, 23. Ai që i ngre bekimet, 24. Ai që lartëson, 25. Ai që poshtëron, 26. Ai që dëgjon, 27. Ai që sheh çdo gjë, 28. Gjykuesi, 29. I drejti, 30. I Buti, 31. I Gjithinformuari, 32. Përdëllimtari, 33. Më i Madhi, 34. Falësi i përgjithshëm, 35. I Mirënjohuri, 36. I Larti, 37. I Madhi, 38. Ai që ruan, 39. Ai që mbikëqyr dhe mirëmban çdo gjë, 40. Llogarimarrësi, 41. I Madhërishmi, 42. Fisniku, 43. Ai që vigjilon mbi çdo gjë, 44. Ai që pranon lutjet, 45. Ai që dashuron, 48. I Lavdishmi, 49. Ai që ringjall, 50. Dëshmitari i çdo gjëje, 51. E vërteta Absolute, 52. Ai që kujdeset dhe përkuajdeset, 53. I Forti, 54. I Pathyeshmi, 55. Mbrojtësi i besimtarëve, 56. I Falënderuari, 57. Njohësi i imtësirave, 58. Nismëtari i krijimit, 59. Rikrijuesi, 60. Jetëdhënësi, 61. Jetëmarrësi, 62. I Gjalli, 63. I Përrjetshmi, 64. Krijuesi, 65. I Nderuari, 66. Një, 67. I Vetmi, 68. Ai tek i cili çdo kush mbështet

tet, 69. I Fuqishmi, 70. I Gjithëmundshmi, 71. Ai që çon përpara, 72. Ai që nuk përfill, 73. I Pari (pa fillim), 74. I fundit (pa mbarim), 75. I Dukshmi (në krijim), 76. I Padukshmi (në qenie), 77. Ai që drejton çdo gjë, 78. I Gjithlartësuari, 79. Mirëbërësi, 80. Ai që pranon pendimet, 81. Ai që ndëshkon, 82. Ai që fal, 83. I Dhimbshmi, 84. Pushtetmbajtësi absolut, 85. Ai, të cilit i takon Madhështia dhe Nderi, 86. Ai që jep drejtësi, 87. Ai që i mbledh (krijesat), 88. Më i Pasuri, 89. Ai që jep pasuri, 90. Ai që privon nga pasuria, 91. Krijuesi i të dobishmes, 92. Krijuesi i të dëmshmes, 93. Drita, 94. Udhëzuesi për në rrugë të drejtë, 95. Krijuesi i pashembullt, 96. I Amshueshmi, 97. Trashëguesi i çdo gjëje, 98. Frymëzuesi, 99. I Durueshmi, i Cili nuk e shpejton dënimin.

Lutjet e të dërguarit të Zotit – Muhammedit a. s.

- Kërkoj mbrojtje tek fjalët e përkryera të Zotit nga shpirtligësia e çdo gjëje, që e ka krijuar.

- E falënderoj Zotin me falënderime të shumta e të mira, me plot adhurim e mirësi, të cilat i do dhe me të cilat është i kënaqur Zoti ynë.

- O Zot, unë të lutem, sepse Ty të përket çdo falënderim, nuk ka Zot përveç Teje, i cili bën mirësi, që nga asgjëja krijove qiejt dhe Tokën, Ty të takon Madhështia dhe Nderi, o Ti i Gjalli që kujdesesh për çdo gjë!

- O Zot, prej Teje kërkoj mbrojtje nga brenga dhe pikëllimi!

- O Zot, na i hap dyert e Mëshirës Sate dhe na i lehtëso dyert e furnizimit Tënd!

- O Zot, më bëj të durueshëm!

- Nuk ka Zot përveç All-llahut të Madh dhe Bujar, nuk ka Zot përveç All-llahut, Zotit të qiejve, Zotit të Tokës dhe Zotit të Fronit të Ndershëm!

- O Zot, unë kërkoj tek ti mbështetje nga dobësia e pleqërisë, nga përtacia, borxhi dhe gjynahu!

- O Zot, kërkoj mbështetjen Tënde nga fatkeqësia e rëndë, mjerimi, nga goditja e shëmtuar e fatit dhe nga hakmarrja e armiqve!

- O Zot, kërkoj mbështetjen Tënde nga sëmundjet, dëshirat dhe veset e këqija!

- O Zot, na dhuro po aq frikë ndaj Teje, saqë do të na pengonte të mos gabojmë ndaj Teje, na dhuro po aq nënshtrim ndaj Teje, saqë do të na çonte në xhennetin Tënd, na dhuro po aq bindje të fortë, saqë do të na i lehtësonte brengat e kësaj bote dhe të botës tjetër. Na jep të dëgjuarit, të parët dhe forcë derisa të jemi gjallë dhe na bëj që me ato dhunti edhe të vdesim.

- Lavdia dhe çdo falënderim qofshin për Ty, o Zoti im! Nuk ka Zot përveç Teje! Prej Teje kërkoj falje, Ty të drejtohem dhe para Teje pendohem!

- O Zot, unë jam robi yt, biri i robit Tënd dhe robëreshës Sate. Lafsha ime është nën pushtetin Tënd... fati dhe caktimi Yt për mua është drejtësi. Të lutem me të gjitha emrat e Tu, me të cilët e ke thirrë Vetën ose me ata me të cilët e ke mësuar cilëndo krijesë Tënde, ose me ata të cilët i ke në dijen Tënde sekrete, që ta bësh Kur'anin e madhërisëm pranverë të zemrës sime, dritë të zemrës sime, që me atë ta largosh hidhërimin tim dhe brengat e mia!

- O Krijues i qiejve dhe i Tokës, Ti je Mbrojtësi im në këtë botë dhe në botën tjetër, më bën të vdes si musliman dhe më shoqëro me njerëz të mirë!

- O Zot, ma përmirëso besimin tim, i cili është kryegjëja ime, ma përmirëso edhe botën time, sepse jetoj në të, ma përmirëso edhe Ahiretin, sepse unë atje do të shkoj, më lër të jetoj deri sa ajo është e mirë për mua, ndërsa ma jep vdekjen, kur të jetë ajo më e mirë për mua. Bëje që jeta ime të jetë shtim në çdo të mirë, kurse vdekja ime paqe dhe shpëtim nga çdo e keqe.

- O Zot, të lutem të ma bekosh të dëgjuarit tim, të parët tim, shpirtin tim, trupin tim, natyrën dhe karakterin tim, familjen time, jetën time, vdekjen time dhe të gjitha punët e mia. O Zot, pranoi veprat e mia të mira

dhe të lutem Ty për shkallë të larta të xhennetit! Ma plotëso lutjen time, O Zot!

- O Zot, të lutem më jep kënaqësi pas goditjes së fatit, jetë të këndshme pas vdekjes, kënaqësinë e shikimit Tënd dhe dashuri në takimin me Ty, më shmang nga çdo vështirësi që do të më dëmtonte dhe sprovë që do të më largonte nga rruga e drejtë.

- O Zot, m'i jep shëndet trupit tim! Nuk ka Zot tjetër përveç Teje!

- O All-llah, që i largon brengat, e lehtëson hidhërimin, që i përgjigjesh lutjes së të dëshpëruarve, që je i Mëshirshëm (ndaj njerëzve) edhe në Dynja edhe në Ahi-ret dhe që je i Dhimbshëm ndaj tyre, më mëshiro mua me aq mëshirë, që të jetë e mjaftueshme, sa të mos i drejtohem askujt përveç Teje për ndihmë.

- O Zot, kërkoj mbrojtje prej Teje, që në pleqëri mos ta humbi krejtësisht fuqinë, kërkoj mbrojtje nga Ti, që në momentin e vdekjes të mos më përmbysë shejtani!

Pejgamberi i Zotit, Muhammedi a.s. ka thënë:

- Kur bën një njeri lutje dhe thotë:

“Ja Rabbi, ja Rabbi!” – “O Zot, O Zoti im!”, All-llahu xh.sh. i përgjigjet:

“Po të përgjigjem, o robi Im, kërko çfarë të duash, do të të jepet!”

- Shprehni shumë shpesh fjalët:

“La havle ve la kuvvete il-la bil-lah”, sepse ato e mbrojnë njeriun në 99 raste nga fatkeqësitë, prej të cilave më e vogla është brenga dhe hidhërimi.

Për emrin e All-llahut xh.sh. “El-Hajj” – “I Gjalli”, Muhammedi a.s. ka thënë se ai është Emri më i madh i All-llahut xh.sh. dhe, kur i bëhet me të lutje për diçka, Ai i përgjigjet dhe ai pranon lutjen. Pejgamberi i Zotit, Muhammedi a.s. ka thënë:

“Kur i ndodh dikujt prej jush ndonjë fatkeqësi, le ta këndojë këtë ajet kur’anor:

/Esteidhu bil-lah/

“Inna lil-lahi ve inna ilejhi raxhiun!” – “ne jemi të All-llahut dhe atij do t’i kthehemi!”

Dhe pastaj le të fillojë lutjen: “O Zoti im! E di që ti ma dërgon këtë fatkeqësi (si vërejtje). Të lutem, më shpërble me atë që ta përballoj dhe ma zëvendëso këtë fatkeqësi me diçka që do të jetë më e mirë se ajo!”

- Kur hyn tek i sëmuri kërko nga ai që të bëjë një lutje për ty, sepse lutja e tij është e ngjashme me lutjen e melekëve (engjëjve).

- Fjalët “Hasbun’All-llahu ve ni’mel-vekil!”

“Më mjafton mua All-llahu! Sa mbrojtës i shkëlqyeshëm është Ai!”

I japin siguri atij që ka frikë nga diçka.

- Prej fatkeqësive (përveç mundësive të tjera) mbrohuni edhe me lutje.

Kur ju ndodh një fatkeqësi, vështirësi apo sprovë, thoni:

“All-llahu Rabbuna, lasherike lehu!”

“All-llahu është Zoti ynë, Ai nuk ka shok!”

- Fjalët e ngushëllimit janë.

“La ilahe il-lAll-llah, Rabus-Semavati’s-Seb’i ve Rabbul-Arshi’l-kerim”.

“Nuk ka hyjni përveç All-llahut. Ai është Zoti i shtatë qiejve dhe Zot i Arshit fisnik.

Këshilloni ata që janë në agoninë e vdekjes, ata që ndahen nga shpirti, që sa më shumë t’i shprehin fjalët:

“LA ILAHE IL-LALL-LLAH!”

- Një nga lutjet më të mira me të cilën njeriu i drejtohet ZOTIT të vet është: “All-llahumme, inmi es’eluke-l-mu’afate fid – dunja ve-l-ahireh!”

“O Zot, Ty të lutem që të më ruash nga çdo e keqe dhe fatkeqësi në këtë botë dhe në botën tjetër!”

Fatin s’mund ta ndalë asgjë përveç lutjes, as jetën nuk mund ta zgjasë asgjë përveç bamirësisë.

Hasan Basriu, duke qenë i sëmurë, u lut:

- O Zot, mos më bëj nga ata të cilët, kur sëmuren, atëherë pendohen dhe, posa të shërohen, përsëri bien në sprovë, ndërsa, kur bëhen të varfër, hidhërohen! O Zot, ma jep kënaqësinë e atij që është i kënaqur me Ty. Më ruaj në këtë jetë, por edhe pas vdekjes sime!

Bamirësia

“Ai që i është dorëzuar All-llahut dhe është bamirës, ai e ka shpërblimin e vet tek Zoti dhe këta nuk do të kenë frikë, as pikëllim. (El-Bekare (2): 112)

“A ka shpërblim tjetër për mirësinë përveç mirësisë”. (Err-Rrahman (55): 60)

Detyra e shenjtë e kryerjes së bamirësisë është një nga bazat e islamit, mbi të cilën mbështetet jeta dhe vepra e besimtarit. Ajo për nga pikësynimet që ka mund të shtrihet në përmasa kolosale, ndërsa begatitë e shpërblimit të All-llahut xh.sh. për ata që shkojnë rrugëve të mirësisë janë të pakufishme. Ky shpërblim vjen gjithmonë në momentet më të kërkuara.

Atë që bën mirë, e ndihmon Zoti xh.sh. në momentin e sprovës. Atëherë kur ai është katandisur keq nga sëmundja, hidhërimi e vështirësitë, All-llahu xh.sh. dhe psikikisht, edhe fizikisht ia lehtëson gjendjen. Në zemrën dhe shpirtin e tij lëshohet ngrohtësia e paqes dhe e ngushëllimit aq shumë e kërkuar, sepse nëpërmjet veprave të mira, nëpërmjet jetës që ia përkushtoi Zotit xh.sh., ai hyri në radhën e të afërmve të Tij, në radhën e atyre të cilët quhen miq të All-llahut xh.sh. All-llahu xh.sh. kurrë nuk do t'i lërë pa ndihmë. Madhështia e pranisë së Zotit xh.sh. do t'ia mbushë jetën besimtarit plot me paqe, prehje në çdo vështirësi dhe në çdo sprovë.

Forca mistike që vjen nga hapësirat e panjohura për ne, do ta ngrejë shpirtin e tij në ato lartësi, në të cilat

ekziston vetëm ajo kënaqësi që është përcaktuar nga All-llahu xh.sh. Dhe kështu paqja e fituar, për vëzhguesin e thjeshtë në mënyrë të pabesueshme do t'ia lehtësojë gjendjen e tij shpirtërore dhe fizike. Ai bëhet me ndihmën e Zotit, prej atyre të cilët e tejkalojnë ankthin e vdekjes. Pranë Tij (All-llahu xh.sh.) edhe kur je në gjendje të mirë, edhe kur je në gjendje të vështirë ekziston vetëm fjala paqe, paqe e pakufishme.

Bamirësitë që kishte bërë në çdo hap, sadakaja që kishte dhënë pa ndërprerje, zemra e tij e mëshirshme e cila për çdo kënd kishte fjalë ngushëllimi e shprese, si dhuratën më të bukur ia sollën lutjen (duanë) e atyre të cilëve u kishte ndihmuar.

Madje edhe zogu të cilin në dritaren e tij e kishte ushqyer, lulja të cilën e kishte ujitur, thnegla, shtëpinë e së cilës e kishte ruajtur në mënyrën e tyre të veçantë të lavdërimit të Zotit e përmendin edhe atë që u kishte ndihmuar. Në këtë mënyrë ai bëhet njeri, praninë e të cilit e bekojnë të gjithë, ardhja e të cilit sjell gëzim. Kufijtë e kënaqësisë së tij nuk kanë fund, e si mund të kenë fund? Me atë është i kënaqur Zoti i gjithësisë. Me atë është i kënaqur Miku i tij më i Mirë.

Muhammedi a.s. për bamirësinë dhe sadakanë ka thënë:

- “Shëroni të sëmurët me sadaka. Sadakaja e dhënë në orët e mëngjesit e mbron njeriun nga çdo fatkeqësi (që mund t'i ndodhë) atë ditë.”

- “Sadakaja e vërtetë, bamirësia ndaj prindërve dhe kujdesi ndaj të afërmeve e shndërrojnë fatkeqësinë në lumturi, e zgjasin jetën dhe e mbrojnë njeriun nga fatkeqësitë dhe shkatërrimi”.

- “Veprat e mira e mbrojnë njeriun nga e liga e fatkeqësia, kurse sadakaja e fshehur e zbut urrejtjen e All-llahut”.

- “Kush u bën mirë prindërve dhe u bindet atyre, lum si ai! All-llahu do t'ia vazhdojë jetën.”

Duhet të mjekohemi

Përveç sabrit (durimit) dhe lutjes së drejtuar All-llahut xh.sh. për ngadhënjimin e sprovës, besimtari duhet të bëjë përpjekje me të gjitha mënyrat e mira, që të mënjanojë sëmundjen dhe të kthehet përsëri në jetën aktive i shëruar e i shëndoshë. Këtë e kërkon islami nga pjesëtarët e tij, prandaj është detyrë për çdo musliman të veprojë ashtu, sepse shëndeti është njëra nga pasuritë më të mëdha që All-llahu i dhuroi njeriut.

I dërguari i Zotit xh.sh. – Muhammedi a.s. ka thënë:

“O njerëz, kërkon shërim, sepse All-llahu xh.sh. nuk ka dhënë asnjë sëmundje për të cilën nuk e ka dhënë edhe ilaçin e saj, vetëm për një jo – ajo është pleqëria.”

“All-llahu i lartësuar e ka dhënë sëmundjen dhe për çdo sëmundje ka dhënë ilaçin e saj. Prandaj, shërohuni! Mirëpo, mos kërkon shërim në atë që është e ndaluar”.

Hazreti Aliu ka thënë:

“Nëse ndodh ndonjë fatkeqësi, përpigu ta shmangësh. Nëse nuk mundesh, përballoje me trimëri”.

Besimtari i sëmurë është në rrugën e shenjtë të fesë islame, nëse kërkon ndihmën e mjekut dhe përdor ilaçet që këshillon ai. Këto janë dhunti të Zotit xh.sh. për t'i lehtësuar njerëzit nga dhembjet, për të ndihmuar trupin dhe shpirtin, që të dalë nga sprovat e shëruar. Në këtë mënyrë njeriu duke përballuar sëmundjen dhe duke mbizotëruar vuajtjet pasuron përvojën e tij për një jetë shpirtërore më të lartë e më serioze.

Kundër sëmundjes duhet luftuar me çdo gjë që është e lejuar. Kthimi i të sëmurit në jetën e shëndoshë e normale, në qoftë se realizohet ajo, është detyrë e rëndësishme për besimtarin. All-llahu xh.sh. ia dha njeriut jetën me mision të caktuar, qoftë ai i shëndoshë apo i sëmurë. Çdo besimtar do ta kryejë vullnetin e Zotit xh.sh. sipas mundësive të tij. Kuptohet, kur njerëzit janë të shëndoshë do t'i kryejnë në një mënyrë të caktuar dhe më aktive detyrat e tyre (sepse mundësitë fizike janë më të mëdha), ndërsa kur janë të sëmurë, ata do të bëjnë të njëjtën gjë, por sipas mundësive të tyre.

Në çdo rast ato duhet të jenë vepra të mira dhe të pëlqyera nga Zoti xh.sh.

Në qoftë se në dukje sëmundja është e pathyeshme, edhe atëherë nuk duhet të dëshpërohemi. Dëshpërimi dhe lotët nuk duhet të jenë shoqërues të besimtarit. Vendin e tyre e zë lufta për ekzistencë, për një jetë të shëndoshë. Besimtari duhet ta pranojë me vetëdije të plotë gjendjen e sëmurë, madje edhe atëherë kur shfaqen të meta fizike, të cilat sipas kriterëve tona njerëzore janë të pandryshueshme. Besimtari duhet ta dijë se çfarëdo të metash fizike që të ketë, ato mund të kapërcehen e të ngadhënjehen, vetëm duhet të kemi vullnet dhe t'i lute mi Zotit të Dashur për ngadhënjimin e tyre. Kjo dëshirë dhe përpjekje patjetër duhet të jetë këmbëngulëse dhe e patundshme. Shumë të paralizuar, të verbër, të shurdhër, memecë, me ndihmën e Zotit dhe forcën e vullnetit, e kanë gjetur vendin e vet në jetën aktive dhe u kanë sjellë shumë dobi të afërmve, mjedisit të tyre dhe së fundi edhe vetvetes. Herë-herë në disa veprimtari fizike i kanë tejkaluar aftësitë mesatare njerëzore.

Në përpjekjet e tyre fisnike ata zhvillojnë aftësi e mundësi të fshehura, për të cilat as nuk kanë imagjinuar se ekzistojnë. Paaftësitë e tyre fizike i zvogëlojnë në ma-

sën më të vogël të mundshme, ndërsa aftësitë tjera ekzistuese i zhvillojnë deri në maksimum. Këtë e bëjnë me forcën më të madhe të vullnetit dhe me ushtrime të gjata këmbëngulëse. Frymëzimin e marrin nga besimi... Besimi e ushqen forcën e vullnetit.

Sepse duhet të dimë.

Sa shumë vullnet i duhet të paralizuarit vetëm që ta bëjë hapin e parë, që të ngrejë në shkallë këmbën e paralizuar! Sa shumë vullnet duhet vetëm që të kompensohet me aftësi të tjera e meta e të dëgjuarit, që të zhvillohet mundësia e lëvizjes kur janë sytë në errësirat e përjetshme! Sa forcë e madhe u duhet atyre që janë edhe të shurdhër, edhe të verbër, edhe memecë vetëm për tejkalimin e pengesave të izolimit dhe të futjes së tyre në botën e atyre që janë të shëndoshë!

Dhe një sërë pengesash deri në pakufi me të cilat ballafaqohen të dëmtuarit. Mirëpo, pikërisht për këtë besimtari me forcën e zemrës së tij çdo pengesë mund ta kapërcejë.

Besimtari me luftën e tij heroike për ngadhënjimin e sëmundjeve dhe të metave fizike, për vendin e tij në jetë dhe në punë të dobishme do të fitojë, nëse do Zoti dhe do të vazhdojë misionin e tij falë veprave të mira, duke u dhënë nevojtarëve dhe duke përhapur lumturinë në zemrat e njerëzve.

Hellen Keller, nëntëmbëdhjetëmuajshe u bë e shurdhër, e verbër dhe memecë. Me përpjekje të vazhdueshme dhe me vullnet të fuqishëm ia arriti të tejkalonte çdo pengesë fizike me të cilat ballafaqohej. Mori doktoraturën e filozofisë në Radcliffe college (SHBA). Shkroi shumë vepra. Gjithë jetën luftoi për t'i ndihmuar të gjymtuarit, të cilët kishin pasur fatin e saj.

Joni Eareckson në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare, duke u larë në det, theu vertebrat e qafës, gjë që i shkak-

toi paralizën e duarve e të këmbëve. Por ajo nuk u dorëzua. Përkundër çasteve të vështira e pranoi, me besim te Zoti, domosdoshmërinë e paralizës së vazhdueshme dhe jetën në karroca fëmijësh. Mësoi që me penel në gojë të pikturojë dhe të bëjë vepra të shkëlqyera artistike. U bë edhe predikuese e fesë. Shkroi edhe librin mbi luftën e saj për të hyrë sërish në jetë. Në fund të librit të vet, me rastin e mbylljes së një ligjrate mbi nevojën dhe kënaqësinë e besimit në Zotin ajo tha: “Besoj që këtu, si dhe në takimet e tjera – shumica e të rinjve do të përcaktohen për Zotin. Atëherë do të jem mirënjohëse, madje edhe në qoftë se këtë e bën vetëm një person. Në qoftë se këtë do ta bënte vetëm një invalid nuk më dhimbset fare jeta ime e kaluar tetë vjet në karroca invalidësh”.

Krahas shërimit me barna dhe metoda të tjera që zotëron mjekësia bashkëkohore, në luftën kundër sëmundjes duhet të kihet parasysh edhe gjendja psikike. Që nga kohërat më të vjetra, prej Hipokratit, Galenit, nëpërmjet mjekëve kinezë, indianë, persianë, arabë e deri tek mjekësia e sotme është e njohur se ç’ndikim të fuqishëm në shfaqjen e sëmundjes, zhvillimit, madje edhe në shërimin e saj ka gjendja e brendshme shpirtërore e njeriut. Nëse njeriu ka shpirt të gëzuar, plot shpresa e energji, gjasat e tij për profilaksinë e sëmundjes, lehtësimin, madje edhe shërimin e saj janë më të mëdha se tek ai i cili është i varfër për nga ato vlera psikiatrike. Është e njohur një anekdotë nga Greqia e vjetër. Kur Sokrati (470-399 p.e.s.) u kthye nga lufta, tha: “Thrakasit e kanë mjekësinë më të mirë se grekët, sepse e dinë që nuk mund të shërohet trupi, po s’u shërua shpirti.” Për më tepër edhe Galeni (200-130, p.e.s.) thoshte se “gratë melankolike sëmuren më shpesh nga kanceri se ato që janë me natyrë të cekët e të gëzuar”. Që në lashtësi është ditur se sëmundja është pasojë e një varg faktorësh, ndër

të cilët rol shumë të rëndësishëm dhe serioz luajnë faktorët biologjikë, socialë dhe psikologjikë, prej të cilëve, secili veç e veç është në gjendje ta aktivizojë sëmundjen, ta intensifikojë apo edhe të ndikojë në shërimin e saj të pjesshëm apo të plotë.

Një mori e tërë faktesh flasin që shumë sëmundje kanë lidhje me komponentët psikikë në kuptimin pozitiv ose negativ, d.m.th. ndikojnë për shfaqjen, zhvillimin apo zhdukjen e sëmundjes, për shërimin ose përfundimin e saj vdekjeprurës.

Në Enciklopedinë e mjekësisë (Zagreb, MCMLXX, Jugoslovenski Leksikografski Zavod), në tekstin mbi sëmundjet psikomatike shkruan: “Mund të thuhet se gati nuk ka degë të mjekësisë, në të cilën nuk mund të gjendet ndonjë motiv psikik me rastin e studimit të etiologjisë së sëmundjes tek njeriu.”

Ndërsa për gjerësinë e shtrirjes së sëmundjeve psikomatike Shoqata psikiatrike amerikane ka dhënë një pasqyrë të cilën po e paraqesim në vazhdim.

I. SËMUNDJET E LËKURËS

- a) anket
- b) uritkaria
- c) neurodermatiti
- d) edema angioneurotike

II. SËMUNDJET DIGJESTIVE

- a) spazmi pilar dhe kardiak
- b) ulkusi gastrik
- c) ulkusi duoden
- d) kolopatite
- e) koliti ulceroz
- f) enteriti regjional

III. SËMUNDJET RESPIRATORE

- a) astma bronkiale
- b) turbekulozi

IV. SËMUNDJET KARDIOVASKULARE

- a) sëmundja koronare
- b) hipertonia esenciale
- c) aritmia

V. SËMUNDJET ENDOKRINE

- a) diabetes mellitus (diabeti)
- b) hiperinslinizmi
- c) hipoglicemia
- d) hiper-tireodizmi

VI. SËMUNDJET REUMATIKE

- a) artriti reumatoid
- b) dhimbjet sarkoiliake

VII. SËMUNDJET GJINEKOLOGJIKE

- a) dhëmbjet menstruale

VIII. TË NDRYSHME

- a) trashja
- b) reaksionet alergjike
- c) migrena dhe dhembja e kokës nga hipertensioni
- d) pruritit ani

Të dhënat janë marrë nga dr. Adamoviq, “Emocionet dhe sëmundjet trupore”.

Përveç informacionit tashmë të paraqitur mbi gjerësinë e shtrirjes së ndikimit të faktorit psikik flet edhe fakti që kohët e fundit u kushtohet kujdes i veçantë problemeve të lidhjes ndërmjet shfaqjes e zhvillimit të kancerit dhe konstitucionit psikik të njeriut.

Dr. Adamoviq në veprën “Emocionet dhe sëmundjet trupore”, (Beograd, Nolit, 1983), thotë se eksperiencia shekullore e mjekëve praktikë vazhdimisht ka dëshmuar se i sëmuri që është me kancer në gjendje depresive ka mundësi më të këqija se një i sëmurë tek i cili gjendja është normale.

Në bazë të punimeve të studiuesve të njohur, të cilët u morën me problemet e onkologjisë psikomatike: “Baltrusch H.J.: “The psychosomatic approach toward cancer, present status, Kongresi IV i kancerologëve të Jugosllavisë, Lubjanë 1979)” dhe Vuliermier F.: “Quelques experiens du psycohogijje medical face au malade cancerux.” Instituti Calmetes, Marseille, 1975, dr. Adamoviq në veprën “Emocionet dhe sëmundjet trupore” shkruan se studiuesi dhe gati të gjithë mjekët që praktikisht punojnë me të sëmurë nga kanceri, mendojnë se një nga kushtet themelore të shërimit të kësaj sëmundjeje është mbajtja e gjendjes normale. Përvojat e tyre gjithashtu kanë vërtetuar se çdo gjendje depresioni që shfaqet me humbjen e oreksit, me pagjumësi, ndjenjë dëshpërimi etj., shpejt i keqëson simptomat e sëmundjes themelore dhe duhet shëruar sa më energjikisht me psikoterapi dhe barna që i ka farmakologjia në arsenalin e vet kundër depresionit.

Është vërtetuar se ndërmjet forcave mbrojtëse të organizmit dhe punës së sistemit nervor qendror ka një lidhje të ngushte dhe se forcat mbrojtëse do të jenë dukshëm më të dobëta përderisa personi është në gjendje depresioni. (Bahnsen O.B.: “Sters and cancer; the state of the art”, Psychosomatic, 21.12.1980).

Është shumë me interes tema e shërimit spontan nga kanceri, Shkencëtarët japonez Nakagëa dhe S. Ithemî në studimet e tyre “A Psychosomatic study of spon-taneus regresian of cancer, “herapy in psychosomatic

medicine”, vëll. 2, Pozzi Roma, të ligjëruara në Kongresin psikomatik Ndërkombëtar në Romë në vitin 1975, shkaktuan sensacion jo të vogël me ligjëratat e tyre për shërimin spontan të kancerit.

Dr. Adamoviç në lidhje me ligjëratën e tyre, në “Emocionet dhe sëmundjet trupore” shkruan: “Nakaçëa dhe Ithem i kanë studiuar 13 të sëmurë, tek të cilët ishte zhdukur tumori pa shërim. Studimet e përmendura të këtyre dy shkencëtarëve kanë përjashtuar çdo mundësi gabimi: diagnoza e karcinomit është vendosur patohistologjikisht, zvogëlimi dhe zhdukja e tumorit nuk kishte lidhje me asnjë lloj shërimi, por ishte një periudhë e gjatë e të mbijetuarit që nga momenti i diagnozës së tumorit deri te çasti i studimeve, ndërsa në disa raste vdekja është shkaktuar nga shkaqe që nuk kanë pasur fare lidhje me tumorin. Kjo seri e vogël e të sëmurëve i bëri të përfundojnë se numri i shërimeve spontane të kancerit është shumë i vogël, gati i parëndësishëm (mësimi që duhet të marrim nga të gjitha këto është i qartë: mrekullitë ndodhin rrallë, prandaj nuk dëshirojmë që të theksuarit e këtij punimi të shërbejë si shembull i keq për ata të sëmurë, të cilët, për disa shkaqe personale, refuzojnë të shërohen dhe në këtë mënyrë e humbasin kohën e çmuar!), se rezultati i zvogëlimit të masës së tumorit ka ardhur me aktivizimin e faktorëve imunologjikë antitumororë. Dhe së fundi, këta persona nuk kanë treguar kurrfarë reaksionesh... depresive si në kohën e diagnozës, ashtu edhe më vonë. Duke marrë parasysh vlerat e veçanta jetësore që mbretërojnë në atë vend të largët (Japoni), autorët theksojnë se njëri nga shkaqet e aktivizimit të tillë të forcave mbrojtëse ka qenë ndryshimi i shpejtë në ekzistencë, një kualitet i ri në të përjetuarit e jetës që ka rezultuar pas diagnozës, e kjo do të thotë një rilindje (ripërtëritje) e vërtetë shpirtërore (konvertim je-

tësor). Fatkeqësisht, një përshkrim më i hollësishëm i këtij transformimi ekzistencial të atyre personave nuk vazhdoi më.

Dr. Petar Stanković në veprën e tij “Mjekësia hyjnore”, Beograd, 1986, si rast karakteristik të ndikimit të faktorit psikik në shëndetin e të sëmurit përmend rastin e një vajze 19-vjeçare, e cila duke përjetuar dëshpërim të madh në dashuri, u sëmur nga një shkallë e rëndë e tuberkulozit të mushkërive. Më përpara kishte qenë plotësisht e shëndoshë. Prishja e disponimit, depresionit, humbja e oreksit e dobësuan rezistencën e organizmit dhe krijuan kushte për krijimin e tuberkulozit. U detyrua të shkojë në sanatorium për TBC-në e mushkërive. Aty njihet me një djalë të ri që kishte të njëjtin fat si ajo. Dhembja e përbashkët i afroi dhe mes tyre lindi dashuria. Përkundër ndalesës së rreptë të mjekut, ata u martuan. Dashuria dhe lumturia e realizuar përsëri ngjallën procese në forcat e tyre mbrojtëse dhe në një afat çuditërisht të shkurtër që të dy u përmirësuan dhe dolën nga sanatoriumi.

Lidhur me këtë Dr. Stanković shkruan: “Në këtë rast, kur për shkak të çekuilibrit shpirtëror filluan ndryshime të papërshtatshme në punën e organizmit, i cili atëherë nuk ishte në gjendje t’i kryente funksionet e veta normale, pikërisht atëherë bacili i tuberkulozit arriti të gjente terren të përshtatshëm për zhvillimin dhe shumëzimin e tij. Kur lumturia dhe qetësia ngadhënjyen përsëri, me atë rast u liruan sasi të mëdha energjie jetësore, të cilat ishin në gjendje t’u kundërviheshin ndryshimeve të sapofilluara të sëmundjes, ta pengojnë zhvillimin e tyre dhe të fillojë përsëri funksionimi i rregullt i të gjitha organeve”.

Të gjitha njohuritë shkencore, të kaluara, të sotme mbi shtrirjen e faktorit psikik në luftë kundër çfarëdo së-

mundjeje, besimtarin vetëm mund ta stiumolojnë, t'i japin forcë dhe shpresë për shërim. Kur të gjitha ilaçet e bëjnë efektin e duhur, përse të mos kërkojmë e shpresojmë edhe në gjendjen shpirtërore, sepse mbase pikërisht ajo çon drejt shpëtimit. Dhe së fundi, përse të mos shfrytëzohet ilaçi shpirtëror, për rëndësinë dhe të vërtetën e të cilit është folur tashmë aq shumë, të shfrytëzohet njëkohësisht me ilaçet mjekësore. Prej tij ka vetëm dobi e kurrresi nuk ka dëm.

Hapësirat e burimeve shpirtërore dhe forcat e tyre janë me të vërtetë të mëdha e pa kufi për besimtarin. Besimi i mu'minit (besimtarit) është një rezervuar i pashtershëm i fuqisë së tij shpirtërore, i cili duhet stimuluar. Ai mund të nxitet dhe të forcohet nëpërmjet lutjes drejtuar All-llahut të Dashur, nëpërmjet mbështetjes së pazezervë tek All-llahu xh.sh., nëpërmjet përkushtimit ndaj Tij, nëpërmjet sabrit dhe bamirësisë.

Atëherë shtohen dhe vërshojnë me vullnetin e All-llahut xh.sh. vlerat e mira e të dobishme shpirtërore, siç janë: gëzimi, shpresa, optimizmi, besimi në ardhmërinë e mirë shëndetësore, qeshja e fytyrës; gjithë ata faktorë shumë të rëndësishëm për shëndetin e njeriut e të gjitha këto vlera pozitive shpirtërore zgjojnë tek njeriu gati procese të mrekulluesme mistike, të cilat i nxisin të gjithë faktorët tonë të njohur e të panjohur, por të rëndësishëm për rritjen e forcave mbrojtëse të organizmit dhe të qëndresës kundër sëmundjeve. Që të gjitha këto zhvillohen, nganjëherë më ngadalë, herë-herë më shpejt, ndërsa nganjëherë, po deshi Zoti xh.sh., me shpejtësi të mahnitshme për të konceptuarit tonë, por gjithmonë në frymën e Ligjeve të Zotit xh.s. Për çdo rast Zoti i Mirë e i Shenjtë është i pranishëm në çdo përpjekje dhe përjetim njerëzor duke filluar nga lutja dhe të biseduarit e qetë me dilema dhe konflikti në mes së mirës dhe së ke-

qes, përjetimi i sabrit (durimit), tevekuli (mbështetjes), teslimijetit (devocionit), bamirësisë, mëshirës dhe shërimit. Për çdo gjë që e nxit të mirën tek njeriu, për rritjen e vlerave të mira shpirtërore tek ne, All-llahu xh.sh. gëzohet përzemërsisht. Ai kërkon prej njeriut përjetime të mira shpirtërore e fisnike, sepse Ai e di mirë se ato janë të dobishme për njeriun. Përveç kësaj, Zoti xh.sh. kërkon gjithmonë në radhë të parë besimin si forca themelore ngritëse. Atëherë Ai ofron ndihmë të plotë dhe vendimtare. Në luftën e brendshme të njeriut për vlerat shpirtërore dhe për nxitësit e rëndësishëm për shërim, i sëmuri mund të ndihmohet shumë nga të afërmit e tij, miqtë, ata që e mjekojnë dhe e shërojnë. Në përpjekje për mbizotërimin e sëmundjeve, për nxitjen e trimërisë, qëndrësës, shpresës, rrethi i të sëmurit ka një rëndësi të veçantë. Focat e veta shpirtërore i afërmi mund t'i shkrijë në forca shpirtërore të të sëmurit, me vullnetin e vet (rrethi) mund të forcojë vullnetin e të sëmurit, me besimin e vet mund të forcojë besimin e tij, rrethi mund të nxitë pa ndërprerje të sëmurin që të ngadhënjejë sëmundjen me fuqinë e shpirtit të tij.

Në këtë luftë të rëndësishme as i sëmuri, as rrethi i tij nuk duhet kurrë ta humbasin shpresën. Këtu duhet këmbëngulje, pavarësisht nga lloji i sëmundjes, madje edhe kur çdo gjë duket se nuk ka rrugëdalje, besimtari duhet të besojë dhe ta ketë të ditur se Mëshira e All-llahut xh.sh. është e pakufishme dhe se ajo asnjëherë nuk i braktis njerëzit e mirë.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Shfrytëzoni dy ilaçe: mjaltin dhe Kur’anin (i pari është ilaç për trupin, ndërsa i dyti për shpirtin dhe trupin).”

“Fatihaja (d.m.th. këndimi i Fatihasë) është ilaç për çdo sëmundje (shpirtërore dhe trupore)”.

Besimtari shembullor në dhembje

Feja mëson që njeriu duhet të jetë shembull dhe model në jetë. Madje, edhe kur është i sëmurë dhe, kur ka dhembje, besimtari duhet të ketë qëndrim dinjitoz dhe kurajo. Sprova e dhembjes është shumë e madhe, mirëpo fuqia e madhe shpirtërore që ka besimtari në zemër duhet ta ngadhënjejë dhembjen. Fytyra e tij, përkundër halleve e vështirësive, mbetet e kthjellët dhe e gëzuar. Besimtari i sëmurë, pavarësisht nga gjendja dhe sëmundja që ka, duhet gjithmonë ta tregojë fuqinë e besimit të frymëzuar nga optimizmi, i cili nuk njeh dëshpërim, vajtim dhe rënkim. Me buzëqeshjen e tij të drejtuar atyre që e rrethojnë, dëshmon besnikërinë e tij ndaj Zotit xh.sh. dhe tregon sa e madhe është dashuria e tij për Zotin xh.sh.

Por është vështirë të jesh i sëmurë, i paralizuar, të të bëjë luftë zemra me dhembjen, e cila mund të shkatërrojë tërë qenien, është vështirë të luftosh me humbjen e frymëmarrjes... Është vështirë të kalosh ditë e muaj, por edhe vite në shtrat, përkrah qindra problemeve të tjera me të cilat ballafaqohemi në ato raste. Është e vështirë kur mbushen sytë me lot nga dhembja e trupit, e cila përpiqet ta thyejë njeriun moralisht. Është vështirë t'i shikosh gjithmonë të njëjtat mure të dhomës së të sëmurëve dhe të ngjallësh kujtime për shëtitjen tënde, i shëruar dhe i shëndoshë nëpër pyje dhe livadhe të lulëzuara,

me plot aroma të mrekullueshme të pranverës. Po, me të vërtetë të gjitha këto janë përjetime të vështira...

Por, megjithatë durimi i besimtarit dhe qëndrimi i tij heroik do ta ngrejë shumë shkallë më lart pozitën e tij në xhennet duke e plotësuar kështu vullnetin e përcaktuar të Zotit xh.sh. Çdo lëvizje e besimtarit në atë gjendje të vështirë është porsì lutja drejtuar All-llahut xh.sh. Të afërmit dhe ata që e rrethojnë gjatë dramës që zhvillohet para syve të tyre vetvetiu i bëjnë një pyetje vetes: “Ku e merr gjithë atë forcë?” Dhe në mënyrë të çuditshme, por të sigurt, arrijnë tek zjarri i besimit, i cili digjet në zemrën e besimtarit, në shpirt dhe në çdo qelizë të trupit të tij.

Ky është besimi që shndrit fort, i ndezur nga sprova e mbizotëruar, sikurse drita e diellit kur depërton nëpër errësirë të reve.

Ajo dritë e besimit në mënyrë të mrekullueshme futet në zemrat e atyre që janë dëshmitarë të asaj ndodhie misterioze. Ajo është thirrës i qetë në besimin e Një Zoti të Vetëm...

Të gjithë ata që e rrethojnë një të sëmurë të tillë, marrin mësim nga shembulli i tij për fuqinë e besimit në dhembje dhe atyre u rritet guximi e aftësia për të përballuar çdo problem me të cilin ndeshen si njerëz të shëndoshë. Ata e kuptojnë se hallet e tyre janë të vogla në krahasim me vështirësitë e dhembjet që i shohin tek i sëmurit, por njëkohësisht e kuptojnë sa e shkëlqyeshme është të jesh njeri me dinjitet. Me këshilla, pa fjalë, i sëmurit i mëson të shëndoshët. Ai nuk flet, por me buzëqeshjen dhe qëndresën e tij tregon për forcën e madhe të shpirtit të frymëzuar me besim. Njëkohësisht, në mënyrë spontane paraqitet si i nënshtuar ndaj vullnetit të Zotit dhe si lavdëruesi i Emrit të Tij.

Të gjithë ata që janë afër të sëmurit janë dëshmitarë të një triumfi të madh të fuqisë shpirtërore të besimtarit,

e cila bën luftë të madhe me vetveten kundër shkurajimit, frikës e dëshpërimit. Këto janë për të gjithë momente shumë të rëndësishme, të cilat përfundojnë në respekt ndaj çdo gjëje që besimtari i sëmurë ka në zemrën e tij.

Duke e duruar dhembjen, duke e përballuar sëmundjen dhe duke e falënderuar Zotin xh.sh. besimtari i sëmurë bëhet shembull inkurajimi për të afërmit dhe ata që janë përreth tij. Ndriçohen horizontet e errëta të sëmundjes dhe të gjithëve u bëhet e qartë e vërteta se me besim tek Zoti asgjë nuk është e frikshme dhe e dhembshme. Dhe me të vërtetë, në atë çka e përjeton i sëmuri ka diçka të bukur, sikur ka diçka të mbinatyrshme në vete! Plagët e të sëmurit, vuajtjet e dhembjet e tij bëhen të dobishme jo vetëm për të, në këtë botë dhe në shpërblijimin e përjetshëm, por edhe për ata që marrin pjesë në dhembjen e tij dhe e përjetojnë thellë atë. I sëmuri i gostit të afërmit e tij me bujari shpirtërore me të cilën All-llahu xh.sh. e frymëzon fuqishëm me Mirësinë e Tij të pakufishme. Kuraja është shumë e rëndësishme në shtyratën e të sëmurit dhe shprehja e saj në ato momente duhet admiruar.

Dijetari i njohur romak i lashtësisë Seneka, duke i përjetuar vuajtjet e sëmundjes tha se kuraroja e të sëmurit në shtratin e tij është baras me trimërinë e legjionarit romak në fushëbetejë.

Ja një tregim mbi njeriun e madh dhe të dërguarin e Zotit xh.sh., Ejubin a.s. Ai jetoi në kohëra të lashta në qytetin USU. Kishte një familje të madhe, shumë pasuri, kope të shumta bagëtish etj. Mbi të gjitha ishte predikues i Fjalës së Zotit xh.sh.

Një ditë e zunë valët e halleve dhe humbi fëmijët, pasurinë, bagëtinë dhe ra në shtrat shumë i sëmurë. Plagë të dhembshme e mbuluan trupin e tij. Të gjithë fi-

lluan të largoheshin nga ai. Prej grave të tij mbeti vetëm Rahmja e ndershme, mbesa e Jusufit a.s., Ejubi a.s. u tërhoq nga njerëzit. Nuk paraqitej askund. Rahmeja e shëronte dhe e mirëmbante duke i bërë punët më të rënda. Kalonin muaj e vite, ndërsa gjendja e tij bëhej gjithnjë e më e rëndë. Duronte dhembje të mëdha, mirëpo nuk u dëshpërua asnjëherë.

Krahas gjithë atyre vuajtjeve e sulmoi edhe djalli (shejtani) duke mos e lënë për asnjë moment të qetë. E sulmonte në besimin e tij. E sulmonte në zemrën e tij.

“Përkujto robin tonë Ejubin, kur me lutje iu drejtua Zotit të vet: Djalli më ka goditur me mundim e dhembje!” (Sad (38): 41)

Shejtani me planet e tij djallëzore donte ta thyente Ejubin a.s. dhe ta detyronte të dorëzohej shpirtërisht dhe moralisht. Duke e shfrytëzuar gjendjen jashtëzakonisht të vështirë të Ejubit a.s., ai nga dita në ditë, gjithnjë e më shpesh dhe më me ngulm i impononte mendime të këqija dhe pyetje e dilema të tilla, të cilat do të trondisnin çdo njeri, që nuk ka besim të fuqishëm në All-llahun xh.sh. Ai me siguri përpiquej t’i bënte pyetje Ejubit a.s. ç’kuptim ka vuajtja e tij, kur tërë jetën kishte bërë mirë, ishte larguar nga e keqja, kishte qenë besimtar i sinqertë e i ndershëm, me një besnikëri të pakufishme ndaj All-llahut xh.sh. E pyeste për vullnetin e Zotit për përcaktimin e shëndetit dhe të sëmundjes, fatit dhe fatkeqësisë, pasurisë dhe varfërisë. Përpiquej ta vinte në dyshim saktësinë dhe drejtësinë e rrugëve e të fateve njerëzore. Dramën e vuajtjes orvatej t’ia paraqiste Ejubit a.s. si një mur të pakapërcyeshëm, që ai besonte se Ejubi nuk do të mund ta kalonte dhe dëshironte që ajo të ishte vdekje shpirtërore për Ejubin a.s.

Në këtë sprovë të tmerrshme, Ejubit a.s. nganjëherë i dukej sikur përreth tij çdokund ishte errësi e patej-

dukshme. I lutej Zotit të dashur, të Vetmit mbrojtës të njeriut. Lutej, me ngulm lutej. E kishte frikë mashtrimin djallëzor. I kishte frikë mendimet e këqija dhe vuajtjet shpirtërore, më shumë se të gjitha dhembjet, të cilat thjesht e kishin katandisur në atë gjendje. Ai kishte shumë frikë se mos po e humbte mëshirën e All-llahut xh.sh. Kishte frikë se mos po e braktiste All-llahu xh.sh., kjo do të ishte humbje e vërtetë! Sepse, çdo vuajtje e kësaj bote, çdo sprovë që na vjen, as që i afrohen së keqes që ndodh me rastin e humbjes së Mëshirës së All-llahut xh.sh.

Buzët e tij të thara përmendnin pa ndërprerje emrin e Zotit xh.sh. Për një moment i shkonte ndërmend t'i lutej Zotit xh.sh. për ta shpëtuar nga vuajtjet duke përmendur pafajësinë e tij, figurën e tij të pastër morale, çiltërinë, përpjekjen e tij që të shkojë rrugës së Zotit xh.sh. dhe të thërrasë për në rrugën e Tij. Mbase kjo do ta ndihmonte në vuajtjen e tij, por ai mendim ishte i çastit dhe nuk mund të depërtonte në zemrën e Ejubit a.s. Ai e ndiente që të theksuarit e vlerave të veta gjatë lutjes dhe shfajësimi nuk është rrugë e drejtë.

Jobi mori fjalën e tha:

“Vërtet e di se ashtu është, para Hyjit kush mund të ketë të drejtë?”³ (Libri i Jobit, 9, 2)

E ndiente Ejubi a.s. që njeriu duke i theksuar vlerat e veta nuk mund të jetë asnjëherë nën Mëshirën e All-llahut xh.sh. Vetëm duke e mohuar të drejtën e gjykimit të plotë mbi fshehtësinë e paarritshme të jetës, fateve njerëzore dhe çdo ngjarjeje, njeriu i afrohet Zotit xh.sh. Ai e dinte dhe e ndiente në thellësinë e qenies së tij që Zoti xh.sh. nuk kërkon që njeriu të arsyetojë vetëm duke i theksuar veprat e veta të mira që ka bërë në të kaluarën as duke i përmendur angazhimet e tij në rrugën e së mi-

³ Biblia: Besëlidhja e vjetër dhe Besëlidhja e re. Drita, Ferizaj, 1994, fq. 630.

rës, por në vuajtjet e sprovës kërkon besim të pastër, të fortë prej graniti si dhe besnikëri absolute të njeriut ndaj Krijuesit të vet. Në këtë rrugë njeriu duhet patjetër të ketë kurajë dhe të jetë dinjitoz.

Prandaj, lutjet e Ejubit a.s. nuk qenë dëshpëruese që thërrisnin duke kërkuar pafajësi si dalje nga pozita e vështirë. Edhe kur ishte i shtrirë në shtrat, plotësisht i paaftë, i dobët, i dërrmuar dhe, kur nga goja e tij mezi dëgjohej pëshpëritja, ai me përvujtëri i lutej All-llahut xh.sh. për vuajtjet e tij...

“Mua më gjeti belaja, e Ti je më i mëshirshmi Mëshirues”
(El-Enbija (21): 83)

Kjo ishte një lutje e mrekullueshme drejtuar Zotit xh.sh. nga një qenie me përkushtim të pakufishëm dhe plot besnikëri e guxim. Për fatkeqësinë e vet kërkonte vetëm mëshirën e më të Mëshirshmit. Sa forcë të madhe dhe besim të fuqishëm do të ketë pasur Ejubi a.s. që i përballoi me durim vuajtjet e atyre viteve të vështira. Ejubi a.s. ishte njeri i jashtëzakonshëm. Si i tillë ai dinte më shumë se të tjerët, sepse ky ishte vullneti i Zotit xh.sh. Ndërsa gjatë sëmundjes dituria e tij shtohej gjithnjë më shumë e më shpejt. I vërente edhe ato gjëra të cilave më parë nuk u kishte kushtuar rëndësi. Hapësirat e pakufishme të qiellit, yjeve, merimanga në rretetë, këndimi i zogjve, shiu i cili ngjalli bimët e vdekura... të gjithë, çdo gjë i fliste për Zotin xh.sh. tani në mënyrë të jashtëzakonshme, duke ia forcuar besimin e tij edhe ashtu të fortë.

Në çdo gjë që e kishte krijuar Zoti xh.sh. tani e kuptonte edhe më thellë mirësinë e përkryer, qëllimin dhe kuptimin e thellë të saj. Tani i paraqitej shumë qartë e vërteta që Zoti krijon vetëm gjëra të mira, gjithmonë vetëm të mira. Madje, edhe në përcaktimet e Tij që ia bën njeriut në rrugën e jetës çdo gjë është e mirë. Zoti ia dë-

shiron njeriut gjithmonë të mirën, pavarësisht si e konsideron ai atë. Madje edhe sprova, kur të vijë mund të sjellë të mira, në qoftë se njeriu e kupton thellë duke e vlerësuar atë. Të gjitha këto Ejubi a.s. edhe më parë i kishte ndier, mirëpo, vetëm nëpërmjet dhembjes e vuajtjes i kishte kuptuar me thellësinë e shpirtit të tij. Në dramën e vet personale Ejubi a.s. e kishte angazhuar mendjen, por shumë më tepër zemrën e vet, të cilën gjithë kohën e kishte pastruar duke dëshiruar që nëpërmjet zjarrit të sprovës t'ia kthejë atë plotësisht të pastër Krijuesit të vet.

Shqetësimi i shejtanit rritej për aq sa shtohet qëndresa e Ejubit a.s. dhe, sa më shumë parandihej ngadhënjimi i shpirtit të tij të madh. Trimërisht dhe me këmbëngulje vazhdoi rrugën që e çonte deri tek Zoti xh.sh. Oqeani i vuajtjeve që kishin dalë përballë Ejubit a.s. në fillim e që ishin dukur si pengesa të pakapërcyeshme të cilat mund t'ia shkatërronin jetën, tani në dhembjet e mbizotëruara ishin bërë rrugë drejt Mëshirës së Zotit xh.sh.

Ky rast i Ejubit a.s. vërteton faktin e pakundërshtueshëm se, pikërisht dorëzimi i plotë ndaj Zotit xh.sh. me besnikërinë e pakushtëzuar ndaj Tij është rruga e shpëtimit.

Trimëria dhe forca e jashtëzakonshme e besimit shprehej edhe në fjalë, edhe në vepër: “O Zot, unë jam asgjë, ndërsa Ti, me madhësinë Tënde përfshin çdo gjë! Dhe çdo të mirë që kam, Ti ma ke dhënë”.

All-llahu xh.sh. nuk e sprovonte kot Ejubin a.s. Nëpërmjet vuajtjes i tregoi shumë gjëra, të cilat njeriu, po s'i vuajti, nuk do t'i kuptonte. Dhe e bëri All-llahu xh.sh. Ejubin a.s. shembull të denjë mësimi për njerëzit, mbi madhësinë e luftës së shpirtit me të gjitha vëshirësië që i sjell me vete fati i jetës. Ejubi a.s. mbeti përkujtim për brezat e ardhshëm, ndërsa All-llahu xh.sh. për durimin e tij, e shpërbleu duke ia larguar vuajtjet dhe duke ia hapur rrugët e të gjitha të mirave të kësaj bote dhe të botës së ardhme...

“Përkujto edhe Ejubin kur iu drejtua Zotit të vet me lutje: “Mua më gjeti belaja, e Ti je më i mëshirshmi Mëshirues!” Ne iu përgjigëm atij nga mëshira Jonë, ia boqëm ato vështirësi që i kishite, ia kthyem familjen e tij dhe fëmijët dhe e bëmë përkujtim e mësim për të devotshmit.” (El-Enbija (21): 83, 84)

All-llahu xh.sh. e shpërbleu Ejubin a.s. për mbizotërimin e sprovës me kurajë dhe për ngadhënjimin mbi shejtanin shpirtlig.

“Pas këtyre ngjarjeve Jobi jetoi njëqind e dyzet vjet dhe i pa bijtë dhe bijtë e bijve të vet deri në të katërtin brez”. (Libri i Jobit, 42, 16)⁴

Ejubi a.s. ishte i gëzuar pa masë për shkak të mëshirës së madhe të Zotit xh.sh. Ai e lavdëroi Atë duke qenë mirënjohës dhe i lumtur që iu paraqit shumë qartë Zoti xh.sh.

“Jobi mori fjalën dhe iu përgjigj Zotit:

Nuk të njihja veç me të dëgjuar, e tani me sy të pashë!”

Ja çfarë tha All-llahu xh.sh. për Ejubin a.s. me rastin e qëndrimit të tij dinjitoz dhe të shkëlqyeshëm gjatë sprovës:

“Ne e gjetëm atë të durueshëm. Sa rob i mirë ishte ai dhe i kthyer tek Zoti.” (Sad (38): 44)

Në vuajtjen dhe sprovën e Ejubit a.s. çdo njeri mund ta kërkojë pjesën e jetës së vet. Kjo ngjarje na tregon që edhe atëherë kur çdo gjë është e humbur, nuk duhet të dëshpërohemi. Zoti i dashur dhe i mirë mund të ndihmojë gjithmonë dhe Ai ndihmon.

Kur mendojmë për ngjarjet të cilat i ndodhën Ejubit a.s. gjatë rrugës së tij drejt shkallëve më të larta në besimin dhe shpërblimin e Zotit xh.sh., e shohim se ato kanë kuptim dhe janë mësim për njerëzit, të cilët jetuan në kohën e Ejubit a.s. dhe dëgjuan për Ejubin a.s. dhe për ata të cilët lexuan më vonë për të.

⁴ Bibla – Besëlidhja e vjetër dhe Besëlidhja e re po aty, fq. 657.

Të përkujtojmë atë periudhë të lashtë...

Tregimet mbi Ejubin a.s. dhe Rrahmën u transmetuan nëpër fshatra e qytete, nëpër oaza, në karvane. Flitej për fatin e tyre të vështirë, për vetminë, braktisjen nga të gjithë, madje edhe nga më të afërmit, por gjithashtu flitej edhe për besimin e tyre të fuqishëm, për durimin dhe karakteret e shkëlqyera.

Njerëzit bënë pyetje: Kush u jep forcë atyre njerëzve? Nga e marrin atë? Ku e kanë mësuar? Dhe përgjigja vazhdimisht ka qenë një: Vetëm njohja e së Vërtetës së pakundërshtueshme të jetës dhe sekreteve të saj ka mundur t'i japë shpirtit atë fuqi! Mirëpo njerëzit përsëri pyetnin: E çfarë thotë ajo e Vërtetë? Filluan të interesohehin për të, ta kërkonin atë, sepse besonin se vetëm tek ajo do të gjenin prehjen e shpirtave të tyre, të cilat kishin rënë në dëshpërim duke mos parë kuptimin e jetës. Besonin se të gjitha errësitat e dëshpërimit e të pakënaqësisë do të zhdukeshin para njohjes së të Vërtetës së pakundërshtueshme mbi sekretet, të cilat e rrethojnë njeriun në çdo hap të tij.

Ejubi a.s. dhe Rahma me qëndrueshmërinë e tyre të shkëlqyeshme, me dinjitetin e tyre në mjerim, pa fjalë predikonin besimin në Zotin Një, në Krijuesin e Gjallë e të Vërtetë, All-llahun xh.sh. Predikonin besimin në të Mirën, shpresën e prehjes dhe të shpëtimit të shpirtave, në paqen dhe kënaqësinë e përjetshme të çdo njeriu, i cili shkon rrugëve të Zotit xh.sh.

Predikimi i tyre pati efekt të pabesueshëm. Gati nuk pati shtëpi në të cilën ai nuk kishte hyrë dhe aty kishte futur dritën e besimit, kishte pushtuar dhe përvetësuar zemrat e njerëzve.

Dhe kur Ejubi a.s. me vullnetin e All-llahut xh.sh. u shërua dhe së bashku me Rrahmën doli përpara njerëzve duke i ftuar ata në rrugën e Zotit xh.sh. fjala e All-llahut

xh.sh. përhapej pa pengesa dhe mbartte me vete Lajme të Gëzuara. Zemra e Ejubit a.s. në vuajtjen e mbijetuar, tani e rilindur kishte në vete shkëndijën dhe zjarrin e Dashurisë së Madhe për çdo gjë që në këtë botë është e mirë. Dashuria dhe e Mira ndërkaq janë synimi i përjetshëm i çdo njeriu. Ato askush nuk ka mundur t'i kundërshtojë.

Drama e Ejubit a.s. i bëri shumë të qarta sekretet e vuajtjes, kuptimin e dhembjes, qëllimin e rrugëve të fateve njerëzore dhe Madhësitinë e Urtësisë së Zotit xh.sh. në të gjitha ndodhitë.

Kalimi në botën e amshuar

“Çdo krijesë do të shijojë vdekjen! Ne ju sprovovjmë me vështirësi edhe me kënaqësi dhe ju do të ktheheni tek Ne”. (El-Enbi-ja (21): 35)

“Vdekjen, drejt së cilës shkojmë të gjithë dhe me të cilën jemi çdo ditë gjithnjë e më afër, duhet ta pranojmë si pjesë të jetës. Ideja e vdekjes duhet të jetojë me ne, por jo që të na demoralizojë apo të na shpjerë në dëshpërim.

“Edhe kur fle mendo që vdekja është nën jastëkun tënd, e kur të zgjohesh, vëre para syve tu”. (Uvejs, Karani)

Ideja e vdekjes duhet të jetë e pranishme tek njeriu, që të zhvillojë ndjenja fisnike dhe ta bëjë më të thellë e më intensive jetën shpirtërore të besimtarit. Jeta është e shkurtër dhe çdo gjë përfundon me vdekjen. Ditët dhe javët kalojnë me shpejtësinë e rrufeshme të shigjetës. Koha sikur ik me vrap. Dhe kur njeriu një ditë ndodhet në vitet e pleqërisë, me habi vështron si kaloi jeta e vdekja është para dyerve. Ajo erdhi ose vjen si diçka gjithëpërfshirëse, e pashmangshme, përcaktuese. Njeriu besimtar e di se ajo është ndarje e cila thërret për takim në përjetësi.

Çdo mendim mbi vdekjen detyrimisht shtron pyetje mbi kuptimin e jetës dhe mbi çdo gjë që është bërë në jetë. Shumë njerëz të moshuar mund t’i shpjegojnë shumë më mirë këto mendime, të cilat vazhdojnë gjatë tërë ditës e sidomos bëhen më intensive në muzgun e

mbrëmjes. Duke e ndier frymën e vdekjes, njeriut thjesht i shtrohet pyetja e dobishmërisë së jetës personale. Si kemi jetuar, ku i kemi kaluar ditët dhe netët që i kemi lënë pas? A mbetet ndonjë gjurmë me vlerë pas nesh apo vetëm boshllëku i shkretë e pa kuptim? A kanë qenë rrugët tona të mira apo të këqija? A kemi qenë të dobishëm për çdo gjë të mirë që na rrethon?

Në ato momente të së Vërtetës bëhet i qartë absurditeti i çdo të keqeje, smire, despotizmi, trishtimi, poshtërsie, të cilat disa njerëz ua shkaktojnë të tjerëve me egoizmin e tyre të pangopur, zemërngushtësinë dhe smirën e çuditshme, të cilat i ushqen çoroditja djallëzore e shejtanit. E keqja paraqitet në dritën e saj të vërtetë, si diçka e neveritshme dhe e pakuptueshme. Kur të fryjë pranë njeriut dhe ta prekë fryma e vdekjes, drama e agonisë së vdekjes, të gjitha mendimet fitojnë nga aspekti shpirtëror dhe serioziteti i tyre dimensione kolosale. Akti i agonisë së vdekjes për atë që është duke vdekur dhe për ata që janë vëzhgues është ngjarje e çuditshme në të cilën një jetë në mënyrë misterioze shkon në përjetësi dhe nga një njeri i gjallë mbetet vetëm trupi i ftohtë, i zbehtë, i mbuluar me vellon e vdekjes. Duke u mësuar me vdekjen dhe duke e nuhatur frymën e saj, një pyetje mbizotëron tek të gjithë të pranishmit: Si mund të jetohet duke bërë vepra të këqija, kur e dimë se meleku i vdekjes është lajmëtari i vërtetë i Krijuesit i cili e ka urdhëruar të Mirën, ndërsa e ka dënuar të keqen?

Çdo shpirt njerëzor, madje edhe atë më të egrin e trondit thellë akti i vdekjes, duke ia bërë me dije që vdekja është vazhdimisht afër dhe e pranishme, e sigurt, e qartë dhe e pashmangshme.

Romakët e vjetër kanë thënë një shprehje të urtë:
“Të vdekurit i mësojnë të gjallët”.

Kjo është një e vërtetë e pakundërshtueshme, të cilën e ka vërtetuar praktika e përditshme, por e ka vërtetuar edhe praktika shekullore. Të vdekurit dhe ata që janë në fill të vdekjes i nxisin njerëzit të mendojnë për nevojën e bërjes së veprave të mira dhe të çdo gjëje që është fisnike; memecë, gojëmbyllur dhe me shikime të qelqëzuara flasin në mënyrë të jashtëzakonshme mbi Zotin Krijues.

Këto janë kumtimet e fundit të pashprehura të besimtarit në këtë botë, me të cilat ai iu drejtohet të pranishmëve, iu drejtohet atyre derisa trupi i tij akoma nuk i është dorëzuar tokës nga e cila ka dalë. Në të vërtetë, veprat e tij të mira, ndonëse ai nuk është prezent, do të flasin edhe shumë e shumë kohë pas vdekjes së tij. Gjatë takimit me Melekun e vdekjes dëshmia e besimtarit e shprehur gjatë jetës se: “Nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut, Muhammedi është peygamberi i Tij!” tani, në ato çaste më serioze bëhet e vërteta më e qartë, më e saktë se çdo gjë e përjetuar deri atëherë. Këto fjalë të dëshmisë më të rëndësishme të njeriut nuk dëgjohen si zë i cili hyn në vesh, por ato depërtojnë thellë, thellë, pa kurrfarë pengesash në zemrën e besimtarit. Këto janë fjalët e shpresës së madhe dhe të ngushëllimit më të madh në çastet e ndarjes nga kjo botë. Ato tani, si e Vërteta, provojnë shumë qartë praninë e Zotit, tek i cili kthehet besimtari sikurse tek Miku i Madh. Meleku i vdekjes vjen në formën e lajmit të gëzuar, si shenjë e paqes dhe dashurisë së amshuar. Tashmë të gjithë e dinë se vdekja është Vullneti i Zotit xh.sh. dhe që, Ai i cili na ka dhënë jetën, tani dërgon ftesën për prehje të përjetshme.

Të kuptuarit që vdekjen e dërgon Krijuesi, është ngushëllim i pamatshëm për çdo besimtar. Azraili nëpërmjet vdekjes na shpie nëpër perde sekrete nga kjo jetë kalimtare në qetësinë e përjetshme.

“Çdo gjë që është në Tokë është kalimtare, mbetet vetëm Zoti ynë që është i madhëruar e i nderuar!” (Err-Rrahman (55): 26-27)

Feja na mëson që vdekja është vetëm kalim në jetën tjetër, pas së cilës nuk ka më vdekje. Jeta jonë vazhdohet në përjetësi, prandaj nuk duhet të frikësohemi nga vdekja...

Shpirti i pastër pa gjynahe gëzohet kur vjen ndërrimi i jetës. Ai është gëzim për çdo shpirt besimtar. Shpirti i qetë kthehet tek Zoti i vet i bekuar dhe i lumtur, sepse tërë kohën e jetës së vet të kaluar është përgatitur për atë moment të madh të kthimit tek Krijuesi i vet. I liruar nga prangat e trupit, i gëzohet lirisë dhe çastit të takimit me Zotin xh.sh., trupi vdes, zhduket, ndërsa shpirti mbetet që nesër, në Ditën e Gjyqit të Madh të paraqitet në atë formë që ne nuk e dimë. Duke kaluar nëpër dyert e vdekjes njeriu flak rrobat e kalueshmërisë dhe vesh rrobat e përjetshmërisë, me të cilat do të qëndrojë para All-llahut xh.sh.:

“O ti shpirt i qetësuar plotësisht,

Kthen te Zoti yt i kënaqur,

Por edhe Ai i kënaqur me ty,

Hyr në mesin e robërve të Mi

Dhe hyr në xhennetin Tim!” (El-Fexhr (89): 27-30)

Një i përkushtuar në shoqërinë e Rabije Adevijës (mistike e njohur islame) tha:

- “All-llahu im, ji i kënaqur me mua.”

Rabija në këtë rast iu përgjigj: “Ji ti i kënaqur me All-llahun edhe Ai do të jetë i kënaqur me ty.”

- “E si mund të jem unë i kënaqur me Ty?” – pyeti ky njeri i përkushtuar.

- “Le të të gëzojë fatkeqësia, ashtu si të gëzon begatia, sepse edhe njëra edhe tjetra janë prej All-llahut xh.sh., - i tha Rabija.

Xhelaluddin Rumi ka shkruar gazel të shkëlqyeshëm mbi vdekjen:

GAZELË MBI VDEKJEN

*“Kur të shpërngulem, kur tabuti im
t’u tregojë të gjithëve se kam vdekur
mos mendoni se për këtë botë
pikëllim më ka mbetur!*

*Të mos vajtojë askush për mua,
të mos thotë: “dëm, dëm”,
sepse është dëm të jesh i djallit
e të shkosh atje ku digjet zjarri!*

*Në xhenazën time, për shkak të ndarjes,
le të mos ketë pikëllim,
sepse pikërisht atëherë fati i takimit
do të lulëzojë në shpirtin tim.*

*Kur t’më lëshojnë në varr, askush
të mos thotë: “Krejtësisht u shua”,
sepse për shoqëritë e xhennetit
varri vetëm si paravan është krijuar.*

*Kur të shobësh se po më lëshojnë
Atëherë dije se po më ngrenë,
Kur dielli, Hëna perëndojnë,
vallë, në qiell më pak shkëlqejnë?*

*Njeriu mendon: vdekja është muzgu,
si burg i duket varri
e në të vërtetë, këtu është fjala
për agimin që sapo zbardhi.*

*Cila farë nuk mbin
kur toka në vete e pranon?
E si dysbimi në ringjalje
shpirtin t’ma shqetësojë.*

*Nga pusi del
kova e plotë e fundosur
Prandaj nuk qan shpirti i Jusufit,
derisa turpi lufton me gropën.*

*Kur ta mbyllësh një rrugë,
tjetra vetë atëherë çelet
pra, për vdekjen time
asnjë fjalë pikëllimi të mos flitet.”*

Filozofi romak, Seneka, ka shkruar: “Me mençuri jeton ai që mendon se vazhdimisht po vdes”.

Është një proverb i urtë: “Më kot në fushën e orës e tërheq akrepi prapa, kur vdekja tërheq përpara dhe tërheq me një fuqi më të madhe dhe të papërballueshme. Vdekja është e sigurt, por çasti i vdekjes është i pezull”.

(Mbishkrim në orën e Këshillit bashkiak në Lajpcig)

Romakët e vjetër thoshin:

“Vdekja mbërrin njeriun i cili ikën nga ajo.

Vdekja me nder shpesh e zbukuron jetën e turpshme.

Vdekja e ruan ligjin, e merr mbretin me të varfrin.

Vdekja është kufiri i fundit i kësaj bote.

Është keq ta kërkosh vdekjen, por edhe më keq është ta kesh frikë atë.

Ta kesh frikë vdekjen është më keq se të vdesësh.

Nëse e mposht frikën e vdekjes, do të mposhtësh çdo frikë tjetër”.

Ja mendimet e Ibni Sinasë (Avicënës), mendimtarit shkencëtarit dhe shkëritmarit të madh islam mbi vdekjen, të shkëputura nga libri i tij “Diskutim mbi ilaçin e frikës nga vdekja dhe shërimin e shqetësimeve që burojnë nga ajo: “Faleminderit Zotit – Krijuesit të gjithësisë! Mëshira

e Zotit qoftë mbi të parin tonë Muhammedin a.s. dhe familjen e tij të mirë dhe të dliur!

Frikë nga vdekja mund të ketë vetëm ai i cili nuk e di ç'është në esencë vdekja ose nuk e di ku do të shkojë shpirti i tij, ose, kur të fillojë të shpërbëhet trupi i tij, mendon se do të shkatërrohet edhe vetja e tij dhe shpirti i tij do të humbë përgjithmonë dhe nuk do të ekzistojë më.

Këtë frikë do ta ketë edhe ai person i cili mendon se vdekja ka në vete dhembje të rëndë, e ndryshme nga dhembja e sëmundjes.

Një shkak tjetër i frikës mund të jetë kur një person i caktuar beson në ndëshkimin që do t'i ndodhë pas vdekjes ose për shkak se i dhimbset pasuria dhe gjërat e tjera që i ka fituar.

Të gjitha këto mendime janë të pabaza dhe nuk janë reale.

1. Vdekja nuk është asgjë tjetër veçse ajo që shpirti e braktis përdorimin e veglës së vet – trupin. Shpirti është substancë jomateriale dhe nuk i nënshtrohet shkatërimit. Kur ndahet shpirti nga trupi, ai bëhet i mprehtë, fluid, i pastër nga të metat fizike, larg shqetësimeve trupore dhe i lumtur me një kënaqësi të përkryer.

2. Ai që e ka frikë vdekjen, sepse nuk e di se ç'do të bëhet me të, ai në të vërtetë nuk e ka frikë, por nuk di të vërtetën mbi rrugën e shpirtit kur ai e braktis trupin. Vdekja e plotëson dhe e kompletton esencën njerëzore, e përsos dhe nëpërmjet saj shpirti ngjitet në sferat më të larta. Njeriu duhet të jetojë me të konceptuarit e këtyllë dhe duhet të jetë plotësisht i sigurt që ajo substancë e dëlirë, kur të çlirohet nga trupi, do të bëhet e pastër dhe e kulluar, do të ngjitet në botën më të lartë, do të bëhet e lumtur, do të kthehet tek burimi i vet, do t'i afrohet Krijuesit të vet dhe do të takohet me shpirtat e tjera të mira si dhe do të shpëtojë nga çdo gjë e keqe.

3. Ai që mendon se vdekja ka dhembjen e vet duhet ti dijë që vdekja nuk ka dhembje fare, sepse trupi ka vuajtur dhe ka ndier përderisa ka qenë shpirti në të.

Trupi pa shpirt nuk ka dhembje.

4. Ai që i frikësohet vdekjes për shkak të dënimit, ai në të vërtetë nuk frikësohet nga vdekja, veçse nga ndëshkimi. Mirëpo ndëshkim do të ketë vetëm për ata që kanë kryer vepra të këqija, të cilat e shoqërojnë shpirtin e njeriut dhe pas vdekjes. Ai në realitet e pranon Zotin e vet dhe ka frikë nga pasojat e veprave të bëra. Që të shpëtojë nga ajo frikë, ai duhet të pendohet, t'i lutet All-llahut xh.sh. për falje dhe të mos gabojë më në të ardhmen. E All-llahu xh.sh. është i Mëshirshëm dhe fal shumë.

5. Kush ka frikë nga vdekja për shkak të keqardhjes se po i braktis të afërmit e tij, pasurinë, lavdinë dhe kënaqësinë e kësaj bote, ai duhet të dijë se çdo gjë në këtë botë është kalimtare, do t'u vijë fundi të gjithëve. Nga kjo frikë nuk ka dobi.

Njeriu bën pjesë në atë grup qeniesh, të cilat janë krijuar me Vullnetin e All-llahut xh.sh. si qenie kalimtare dhe çdo gjë që është kalimtare e ka fundin e vet.

Sikur të ishte e mundur që njeriu të mbetej i përjetshëm, më parë do të kishin mbetur ata të cilët kanë qenë para nesh e kjo do të shpinte në pamundësinë e ekzistencës në Tokë.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Përgatitu për vdekjen, para se të vijë ajo!”

“Shpesh vizito varrezat dhe shiko me kujdes varret, që të marrësh mësim (duke menduar për ringjalljen pas vdekjes)”

“Sikur të ishte e mundur të vërehej diçka dhe ajo ç’ka vjen pas saj, do t’i përbuzje të gjitha tekat, të cilat të mashtrojnë dhe të çojnë në rrugë të gabuar”.

Në Hercegovinë, në një nishan të vjetër është shkruar:

“O udhëtar që kalon këtej, ndalu pak, këndo Fatihanë dhe mendo mbi fshehtësinë dhe madhështinë e vdekjes!”

(Le të jetë mësim për njeriun që është kalimtar, se është bërë nga dheu dhe përsëri do të bëhet dhe.

Rabindranat Tagore ka shkruar:

“Vdekja, nëpunësja jote më rri para dyerve, ka ardhur nëpër detet e panjohura dhe më ka sjellë Ftesën Tënde, nata është e errët dhe zemra më është me drithma, por do ta marr kandilin tim, do t’i hap dyert dhe do t’i uroj mirëseardhje. Lajmëtarja Jote rri para dyerve të mia. Do t’i dorëzohem duarlidhur dhe me sy të përлотur. Do t’i dorëzohem dhe para këmbëve të saj do të shtroj pasurinë time.

Kur të ma dorëzojë Porosinë Tënde, do të vijë dhe do ta hedhë hijen e vet në mëngjesin tim. Dhe në shtëpinë time të zbrazët do të mbetet “uni” im i braktisur si dhurata ime e fundit për Ty”. (Tagore, “Gitanialet, 86)

Edhe gjatë jetës, por edhe në momentin e vdekjes mendimet e besimtarit janë të drejtuara drejt Zotit Krijues. Ashtu shprehin dashurinë e plotë me përkushtim ndaj Tij, e cila nëpërmjet fjalëve dhe veprave manifestohet në çdo moment. Përpjekja e besimtarit që jeta e tij të jetë në harmoni me kënaqësinë e All-llahut, shprehet me fjalët:

“Dhe thuaj: “O Zoti im, bëre që të vdes duke qenë Ti i kënaqur me mua dhe bëre që të çohem nga të vdekurit duke qenë Ti i kënaqur me mua dhe më jep forcë nga ana jote që do të më shërbejë si ndihmë”. (El-Isra (17): 89)

Ajo fuqi e mrekullueshme, të cilën ua jep All-llahu xh.sh. besimtarëve të tij besnikë, nuk ka kufi, u jep zemër besimtarëve dhe e bën të kuptimshme tërë jetën nga fillimi deri në mbarim, me plot ngushëllime dhe shpresa i dorëzon të qetësuarit tek Engjëlli i Vdekjes.

Prehja në vdekje

Gëzimi me besim në lindje, gëzimi me besim në jetë vazhdon deri në prehjen e gëzuar të besimtarit me besim edhe në vdekje.

Besimtari nuk duhet ta ketë fare frikë vdekjen, sepse nuk ka pikëllim as frikë për shpirtin e besimtarit. Kështu është premtimi i All-llahut, e All-llahu xh.sh. është e Vërteta dhe Ai me siguri, pa kurrfarë dyshimi i plotëson premtimet e Veta.

“Ta keni të ditur se për të dashurit e All-llahut nuk ka frikë as nuk ka pikëllim”. (Junus (10): 62)

Kjo vdekje që po vjen në të vërtetë nuk është vdekje, zhdukje, por është ndërrim jete, kalim në një gjendje të re, e cila është rrugë drejt jetës së vërtetë, të plotë, të përjetshme.

“Do të vijë momenti i ringjalljes, nuk ka dyshim në të, por shumica e njerëzve nuk do ta besojnë” (Gafir (40): 59)

Një filozof i lashtë misik tha:

“Kjo botë është burg për besimtarin, varri është kështjella e tij e xhenneti është vendbanimi i tij”.

Ideja e takimit me vdekjen, e cila ka qenë e pranishme gjatë tërë jetës dhe që e ka frymëzuar besimtarin për vepra të mira, në momentin e vdekjes bëhet realitet. Në çastin e vdekjes besimtarit i bëhet e ditur se rruga e tij ka qenë rrugë e vërtetë. Ai ka jetuar dhe ka punuar me dritën e Kur’anit në zemër, e cila ia ka ndriçuar shtigjet drejt së Vërtetës absolute. Kjo ka qenë ngritje e përher-

shme pa ngecje, ecje e vazhdueshme përpara, që ka vazhduar edhe në momentin e kalimit nga kjo jetë në shuarjen kalimtare. Ajo ka qenë ecje drejt majave më të larta të së mirës, dashurisë dhe lumturisë së përjetshme, ecje drejt xhennetit. E All-llahu xh.sh. u ka premtuar besimtarëve gëzime e kënaqësi të papritura e të paimagjinuara në xhennet. Do të jenë të shpërblyer me paqe, prehje dhe lumturi të përjetshme. Nuk do të ketë vuajtje as frikë. Ata do të dinë vetëm për begati dhe për bamirësi të vazhdueshme. Atyre do t'ju zbulohen të gjitha bukuritë e Ahiretit, bukuri të cilat njeriu as që mund t'i imagjinojë tani. Xhenneti është vendbanim i amshuar i besimtarit.

Çdo gjë që është përballuar me vuajtje në jetën kalimtare, çdo gjë që atëherë është humbur do të jetë e kompensuar plotësisht në mënyrën më të mirë. Çdo gjë që është prishur në këtë botë do të jetë në mënyrën më të mirë e rregulluar atje. Të gjitha padrejtësitë e kësaj bote do të zëvendësohen me drejtësinë absolute. Të gjitha urrejtjet, ligësitë dhe të këqijat do të zëvendësohen me dashuri, kujdes, mirësi. Në vend të jolumturisë do të ketë lumturi të amshuar. Jeta pranë pejgamberëve të Zotit xh.sh., pranë njerëzve më të mirë, pranë të afërmeve tanë më të dashur, pranë të mirëve dhe miqve do të vazhdojë pandërprerje në kohën e cila nuk ka fund. Prandaj, besimtari është i qetë dhe i gëzuar në momentin e vdekjes.

All-llahu xh.sh. na i paraqet në Kur'an në mënyrë simbolike të gjitha ato të mira me të cilat do të jetë i shpërblyer besimtari. Në krahasim me ato të mira, begatitë e kësaj bote janë pafundësisht të vogla.

“Atyre që thonë: “Zoti ynë është All-llahu dhe pas-taj i qëndrojnë besnik kësaj, u vijnë engjëjt (duke iu thënë): “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni, por gëzohuni për xhennetin që ju është premtuar”. (Fussilet (41): 30)

“All-llahu u premtom besimtarëve dhe besimtareve xhennetin ku do të rrjedhin lumenj e aty do të mbesin përgjithmonë, në zam-bakë fantastikë, në xhennete të Adënit. Kurse kënaqësia e All-llahut është më e madhe se çdo gjë tjetër, ai është sukses i madh”. (Et-Tevbe (9): 72)

“Falënderuar qoftë All-llahu, do të thonë, i cili na i largoi brengat. Zoti ynë fal shumë dhe është bamirës. Ai nga mëshira e Vet na dhuroi neve vendbanim të përjetsëm, ku nuk do të na prekë as lodhja, as rraskapitja”. (El-Fatir (35): 34, 35)

“Për sa u përket fatlumëve ata do të jenë në xhennet, aty do të qëndrojnë përgjithmonë, sa të jenë qiejt dhe toka, përveç nëse ndryshe e cakton Zoti yt, ky do të jetë shpërblim i vazhdueshëm”. (Hud 11): 108)

“Me të vërtetë, ata të cilët besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do ta kenë vendbanim xhennetin Firdeus. Aty do të jenë përgjithmonë dhe nuk do të dëshirojnë ta ndërrojnë me asgjë tjetër”. (El-Kehf (18): 107, 108)

“Askush nuk e di se çfarë gëzimesh të fshehta i presin si shpërblim për atë çfarë kanë punuar”. (Es-Sexhde (32): 17)

“Dhe ngado të shikosh, atje do të shohësh komoditet dhe mbretëri të mëdha”. (Ed-Dehr(Insan) (76): 20)

“Ata do të jenë për shkak se duruan, të shpërblyer me oda xhenneti (shkallë të xhennetit) dhe aty do të priten me përshëndetje dhe selame. Aty do të jenë përgjithmonë. Sa vendbanim e vendstrehim i mrekullueshëm është ai!” (El-Furkan (25): 75, 76)

Dhe shpirtrat e qetësuara e të dlira, me Mëshirën e All-llahut xh.sh. do të hyjnë në xhennet.

“E ata të cilët janë frikësuar nga Zoti i vet do të futen në xhennet në grupe e, kur arrijnë aty, dyert i gjejnë gjerë e gjatë të hapura, ndërsa rojat e tij do t’u thonë: “Selamun alejkum” (Paqja qoftë me ju), keni qenë të mirë, prandaj hyni aty ku do të jeni përgjithmonë!

Dhe ata do të thonë: “Falënderuar qoftë All-llahu i cili e përmbushi premtimin e Vet ndaj nesh dhe na la në disponim to-

kën e xhennetit, që të vendosemi aty ku duam! Sa shpërblim i mirë për ata që vepruan drejt!” (Ez-Zumer (39): 73 74)

Buhariu dhe Muslimi transmetuan hadithin “Kud-sij” vijues:

“Unë kam përgatitur në xhennet për robët e Mi të mirë atë që syri nuk e ka parë, veshi nuk e ka dëgjuar, as mendja askujt nuk i ka shkuar”.

Muhammedi a.s. thoshte se pas dhuntive të xhennetit shpërblimi më i madh dhe i fundit për të përkushtuarit do të jetë të shikuarit e All-llahut xh.sh.

Muslimi dhe transmetuesit e tjerë të haditheve kanë kumtuar fjalët vijuese të Pejgamberit të Zotit – Muhammedit a.s.

“Kur të hyjnë në xhennet ata që e kanë merituar. Zoti do ti pyesë: A keni nevojë edhe për ndonjë gjë tjetër që Unë mund t’ju jap? Të gjithë do të habiten dhe nuk do të dinë çfarë të dëshirojnë. Atëherë vetë Zoti xh.sh. do t’i largojë perdet e padukshmërisë dhe do të heqë Vellon e Vet dhe asgjë që është përjetuar më parë nuk do të jetë aq e çmuar dhe me vlerë aq të madhe, sa ç’është të shikuarit (të parit) e Zotit tonë”.

- Përveç pelerinës së madhësisë asgjë nuk do ta ndajë Zotin nga shikimi i njerëzve.

Pamja e All-llahut xh.sh. është shpërblimi më i lartë dhe më i mirë për besimtarin, për jetën e tij të ndershme e të dliurë në këtë botë kalimtare.

Besimtarët për bukuritë e pakufishme të xhennetit, të mbuluar me Mëshirën e All-llahut xh.sh., do të falënderojnë pandërprerje Emrin e Zotit xh.sh. dhe T’i jenë mirënjohës për mirësinë dhe nderimet që u bëri...

“... dhe ata do të thonë: “Qoftë lartësuar All-llahu, i cili na ka udhëzuar në rrugë të drejtë. Sikur All-llahu të mos na kishte udhëzuar, ne nuk do të ishim në rrugë të drejtë. Pejgamberët e Zotit tonë me të vërtetë e kanë sjellë të vërtetën dhe atyre do t’ju

thubet: “Ai është xhenneti që e keni fituar me veprat që keni bërë!” (El-A’raf (7): 43)

“Ata të cilët besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Zoti i tyre i udhëzon në rrugë të drejtë, sepse besojnë e rrjedhin lumenj pranë tyre në kopshtet e kënaqësisë. Lutja e tyre aty është:

“Qofsh lartësuar, o All-llab!” dhe përshëndetja e tyre “Paqel!”, e lutja e fundit “Falënderimi është për All-llahun, Zotin e botëve!” (Junus (10): 9, 10)

Ndërsa lutja e vazhdueshme e atyre të cilët shkojnë rrugëve të Zotit xh.sh. drejt portave të hapura krab më krab është:

“Kërkoj mbrojtjen e All-llabut nga shejtani i mallkuar!

Në emër të All-llabut, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshirëbërësit!”

“Falenderimi i takon vetëm All-llabut, Zotit të botëve!

Bamirësit të përgjithshëm, Mëshirëbërësit!

Sunduesit të Ditës së Gjykimit!

Vetëm Ty të adhurujmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.

Na udhëzo në rrugë të mbarë!

Në rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mirat e Tua.

Jo në rrugën e atyre me të cilët je hidhëruar, as të atyre të cilët kanë humbur në rrugë”. (El-Fatiha)